



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**MINISTRIA E BRENDSHME  
ZYRA E ZEVENDESMISTRIT TE BRENDSHEM/KOORDINATORIT  
KOMBETAR PER ANTITRAFIKUN**

**STRATEGJIA KOMBETARE SHQIPTARE  
PER LUFTEN KUNDER TRAFIKUT TE  
QENIEVE NJEREZORE**

**Kuadri Strategjik dhe Plani Kombetar  
i Veprimit 2005- 2007**

PERFSHIRE:

**STRATEGJIA KOMBETARE  
KUNDER TRAFIKIMIT TE FEMIJEVE  
DHE MBROJTJES SE FEMIJEVE VIKTIMA TE TRAFIKIMIT**

**MARREVESHJE BASHKEPUNIMI PER KRIJIMIN E NJE  
MEKANIZMI KOMBETAR REFERUES PER IDENTIFIKIM DHE  
ASISTENCE TE PERMIRESUAR PER VIKTIMAT E TRAFIKUT TE  
QENIEVE NJEREZORE**

Tirane, SHQIPERI  
Korrik 2005  
(Ribotuar në korrik 2006)

*Publikuar nga:*

Zyra e Zëvendësministrit të Brendshëm/Koordinatorit  
Kombëtar të Antitrafikut  
Ministria e Brendshme, Sheshi “Skënderbej”, nr. 3  
Tiranë, Shqipëri, tel/faks: +(355) 4 233 540

*Me mbështetjen e*

Programit Ndërkombëtar të Departamentit të Drejtësisë së SHBA  
për Asistencën në Trajnim dhe Ndjekje Penale (ICITAP – Albania)  
Rruga e Elbasanit, 103. Tiranë, Shqipëri  
Tel: + (355) 4 247 285, Faks: + (355) 4 375 165

Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të SHBA  
Iniciativa Shqiptare: Projekti i Veprimit të Koordinuar Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore  
(CAAHT)  
Rruga e Elbasanit 103, Tiranë, Shqipëri  
Tel: +(355) 4 241 999, Faks: + (355) 4 233 520

*Përkthyer nga:*

Z. Darien Guri, Znj. Kreuza Kotorri

*Botuar nga:*

Shtëpia Botuese “Dajti 2000”  
Rr. “Muhamet Gjollësja”, pranë NPV 1, Tiranë, Shqipëri  
Tel: + (355) 4 238 659

*Numri i Kopjeve (në shqip dhe anglisht)*

500 kopje (nuk është për shitje)  
(Ribotuar në korrik 2006)

Shtëpia Botuese “Dajti 2000”  
Gusht 2005  
Tiranë, Shqipëri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

## **URDHER**

**Nr.25, datë 22.2.2005**

**PËR**

**MIRATIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT, PER PERIUDHEN 2005-2007,  
NE ZBATIM TE STRATEGJISE KOMBETARE TË LUFTËS KUNDËR  
TRAFIKUT TË QËNIEVE NJERËZORE”**

**Në mbështetje të pikave 1 e 3, te nenit 102 të Kushtetutës,**

### **URDHEROJ:**

1. Miratimin e Planit te Veprimir, per periudhen 2005-2007, ne zbatim te Strategjisë Kombëtare te Luftes kunder Trafikut te Qenieve Njerezore, i cili bashkelidhet ketij urdhri.
2. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Luftës Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore për ndjekjen, kontrollin dhe informimin per zbatimin e detyrave të caktuara në këtë plan veprimi.

**Ky urdher hyn në fuqi menjehere.**

**KRYEMINISTRI**

**FATOS NANO**





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**  
**ZYRA E MINISTRIT TE SHTETIT PER KOORDINIM**

**STRATEGJIA KOMBETARE SHQIPTARE PER LUFTEN**  
**KUNDER TRAFIKUT TE QENIEVE NJEREZORE:**

**Kuadri Strategjik dhe Plani Kombetar i Veprimit 2005- 2007**

**1. HYRJA**

Ky “Kuader Strategjik dhe Plan Kombetar i Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Qenieve Njerezore 2005-2007” eshte hartuar ne baze te pervojave dhe mesimeve te nxjerra nga te gjitha institucionet kombetare pergjegjese per zbatimin e Strategjise Kombetare per Anti-Trafikun 2001-2004 te Shqiperise, si dhe te Planit Kombetar te Veprimit te fundit te Qeverise, per periudhen 2003-2004.

Qellimi i ketij Plani te fundit, si ai I Planit Kombetar te Veprimit te vitit 2003-2004, eshte te konsolidoje perparimin e bere qe nga momenti i hartimit te Strategjise Kombetare Anti-Trafik 2000-2001 te Shqiperise, dhe ne te njejten kohe te zhvilloje metoda te reja ligjore e institucionale per t’iu pershtatur karakterit ne ndryshim te fenomenit te trafikimit, si dhe te zhvilloje menyra me sistematike, te besueshme e verifikueshme statistikore per te matur rezultatet.

Qeveria e Shqiperise beson se praktika e saj e hartimit te Planeve Kombetare Te Veprimit Anti-Trafik afatmesme, si pjese perberese e nje Kuadri te pergjithshem Strategjik, eshte menyra me e frytshme per t’iu pergjigjur ne menyre fleksible dukurise se trafikimit te qenieve njerezore dhe aktiviteteve nderkombetare kunder tij, si dhe per te shfaqur ne te njejten kohe angazhimin e saj te vazhdueshem per t’i dhene fund trafikimit te qenieve njerezore nga Shqiperia.

Ky Plan Veprimi, nga njera ane pasqyron perparimin e bere dhe boshlleqet e identifikuar ne vleresimet kombetare e nderkombetare te rezultateve te Shqiperise ne keto 12 muajt e fundit. Nga ana tjeter, perpiqet te harmonizojte strukturen e aktivitetit kombetar anti-trafik te Shqiperise me rekomandimet e partnereve nderkombetare dhe te BE, si dhe me praktikat ne zhvillim e siper te fqinjeve rajonale te Shqiperise.

*Si me pare, ky Plan Kombetar Veprimi 2005-2007 mbeshtetet ne parimet e meposhtme:*

- Pergjegjësia kryesore - e qeverise
- Pjesemarrja e shoqerise civile
- Trajtimi i viktimave bazuar tek te drejtat e njeriut
- Bashkerendimi e aktivitetet mes fushave e sektoreve te ndryshem ne nivel ministror e zyrtar, dhe mes qeverise, organizatave nderkombetare dhe OJF-ve;
- Vleresimi sistematik dhe vazhdueshmeria.

Persa i perket perparimit te bere, Plani i Veprimit 2005-2007 pasqyron faktin, te pranuar ne vleresimet statistikore kombetare e nderkombetare, qe megjithese eshte akoma nje vend burimi per trafikun,

Shqipëria nuk është me një vend i rëndësishëm tranziti apo destinacioni. Gjithashtu pasqyron dhe përparimin që ka bërë Shqipëria në miratimin e ligjeve për anti-trafikun sipas standarteve ndërkombëtare, përfshirë këtu amendamentet në Kodin Penal, Ligjin Për Mbrojtjen e Dëshmitareve dhe atë Anti-Mafia, ngritjen e një Gjykate për Krimet e Renda dhe Task Forca Rajonale për Krimin e Organizuar, për të trajtuar, ndërmjet të tjerash, çeshtjet me të renda të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjithashtu po përgatiten një Mekanizëm Kombëtar Referimi për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave të kthyer, si dhe një Strategji kundër Trafikimit të Femijëve (tek e cila një vend të rëndësishëm ze një Marrëveshje Bashkepunimi me Greqinë). Shqipëria gjithashtu ka vazhduar të përmirësojë aftësitë e saj ndaluese në pikat kryesore të kalimit të kufirit, si dhe në pjesëmarrjen aktive me vendet fqinje dhe vende të tjera pritëse në procesin e zhvillimit të bashkepunimit në fushën e zbulimit, zbatimit të ligjit dhe atë ligjor.

Në të njëjtën kohë, vlerësimet kombëtare e ndërkombëtare të rezultateve të Shqipërisë kanë identifikuar disa dobësi e boshllëqe të vazhdueshme, të cilat përqipet t'i ndreqe ky Plan Veprimi. Këto kanë të bëjnë sidomos me bashkepunim të dobët mes policisë dhe prokurorisë, si dhe masa të pamjaftueshme kundër punonjësve të policisë, prokurorisë, gjykatave e zyrtarëve të tjerë të përfshirë në trafikë; si dhe me nevojën për të patur me shumë nisma të qeverisë, përkundërt atyre të OJF-ve, në fushat e mbrojtjes dhe parandalimit. Përsa i përket parandalimit, Plani pasqyron pranimin nga ana e Qeverisë të përgjegjësive se saj për të nxitur me shumë përfshirjen sociale dhe alternativa përkundërt migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, nëpërmjet harmonizimit të nismave për uljen e varfërisë, barazi gjinore, arsimim dhe krijim të vendeve të punës.

Qeveria gjithashtu pranon se shumë prej nismave ambicioze të ndërmarra 12 muajt e fundit në fushën strukturore dhe atë ligjor – për të cilat ka marrë vlerësime ndërkombëtare – kërkojnë me shumë përpjekje të përqendruar për të siguruar zbatim të frytshëm në praktike.

Duke u përpjekur të trajtojë dobësitë dhe mangësitë e sipërpermendura, Plani Kombëtar i Veprimit 2005-2007 ndjek një strukturë të bazuar mbi standartet ndërkombëtare dhe ato të BE, dhe në vecanti, një format model për një aktivitet gjithëpërfshirës anti-trafik të miratuar në maj 2004 nga të gjitha vendet e rajonit të Evropës Juglindore si pjesë e projektit CARDS të BE “Forcimi i Strategjive për Zbatim të Planeve Kombëtare të Veprimit Anti-Trafik të Vendeve të Paktit të Stabilitetit”, i vënë në zbatim nga Qendra Nderkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit (ICMPD).

Në përputhje me këto aktivitet rajonal, Plani Kombëtar i Veprimit 2005-2007 ka një strukturë dy-niveleshë, Strategjike dhe Operacionale, e cila konsiston në Synime Strategjike dhe Objektiva Specifike, si dhe në një Kuader Operacional i cili identifikon aktivitetet që duhen ndërmarë për të vënë në zbatim Planin. Një përmbledhje e Synimeve Strategjike dhe Objektivave Specifike gjendet në Seksionin II (Kuadri Strategjik). Masat dhe aktivitetet e parashikuara për të vënë në zbatim këto Synime Strategjike dhe Objektiva Specifike janë përshkruar në Seksionin 3 (Kuadri Operacional). Ky nivel përfshin gjithashtu përgjegjësitë dhe afatet kohore të caktuara; burimet dhe percaktimet e buxhetit; si dhe treguesit e rezultateve operacionale dhe cilësore.

I mbështetur në formatin model rajonal të ICMPD-se, Plani i Veprimit 2005-2007 trajton nevojat e Shqipërisë në këto fusha kryesore:

### **Hetimi dhe Ndjekja Penale e Krimeve të Trafikimit**

- Hetimi gjatë (aktiv) dhe pas (reagues) kryerjes së krimit, ndërmjet të tjerave edhe nëpërmjet zhvillimit të bashkepunimit dhe mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të përbashkët nga policia dhe prokuroria.
- Ndjekje penale dhe denime të suksesshme të krimineleve
- Masat anti-korrupsion, sidomos kundër punonjësve të policisë, prokurorisë, gjykatave dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në të.
- Zhvenditimi ligjor dhe kompensimi për viktimat
- Trajtim njerëzor policor dhe gjyqësor i viktimave dhe viktimave/dëshmitare, bazuar në metoda

te orientuara drejt te drejtave te njeriut dhe drejt viktimave.

- Mbrojtja e viktimave/deshmitareve
- Bashkepunim nderkombetar ne fushen e zbatimit te ligjit dhe ate gjyqesore.

### **Mbeshtetja dhe Mbrojtja e Viktimave dhe Deshmitareve**

- Permiresimi i Identifikimit te Viktimave
- Krijimi i nje Mekanizmi Kombetar Referues per Viktimat
- Strehim, mbeshtetje sociale dhe mbrojtje per viktimat.
- Mbrojtje per deshmitaret dhe trajtim i sigurte gjate gjyqit i viktimave te trafikimit.
- Permiresimi I procedurave te kthimit dhe integritit per te gjitha viktimat.

### **Parandalimi i Trafikimit dhe Ri-trafikimit**

- Ndergjegjesimi i publikut.
- Futja ne sistemin arsimor si rryme e pergjithshme
- Ulja e cenueshmerise, sidomos persa i perket grave dhe femijeve, si dhe grupeve ne rrezik.
- Nisma per zhvillim shoqeror-ekonomik dhe ulje te varferise.

### **Kuadri Bashkerendues**

- Bashkerendimi nder-institucional ne nivel ministror dhe zyrtar, si dhe me OJF-te e partneret nderkombetare;
- Mbledhje dhe vleresim i sakte i te dhenave
- Mobilizim i burimeve dhe financave
- Rishikim, monitorim dhe vleresim

Ne vecanti, duhet te vihet re se Plani i Veprimit 2005-2007 i jep me shume rendesi sesa planet e meparshme nevojës për të patur mbledhje dhe vleresim të sakte të të dhënave ndër-institucionale. Plani i Veprimit përpiqet ta bëjë këtë duke përfshirë *Kerkesat e Rishikuara për Raportim Statistikor* tek shumica e Objektivave dhe Aktivitetëve Specifike, si dhe duke kërkuar vleresim me sistematik të rezultateve nga Komiteti Drejtues Nder-Ministror dhe Pikat e posacme të Kontaktit në nivel zyrtar.

Mbledhja dhe vleresimi me i sakte i të dhënave konsiderohen si të rëndësishme jo vetëm në rolin e një mjeti për vleresimin e vetvetes dhe arritjen e kriterëve ndërkombetare për raportim, por gjithashtu për të bërë të mundur një përputhje me të madhe mes të dhënave zyrtare dhe atyre të mbledhura nga agjencite kombetare e ndërkombetare jo-qeveritare.

Plani i Veprimit gjithashtu thekson nevojën për bashkerendim efikas në nivel ministror dhe zyrtar për mobilizimin e burimeve të mjaftueshme financiare për venien në zbatim të Planit. (Do të hartohet vecmas dhe një buxhet i detajuar ndër-institucional për venien në zbatim të Planit, duke koiciduar me aktivitetin e përvitshëm të Qeverisë, për buxhetin e vitit 2005, si dhe me përgjigjet nga partneret zbatues në lidhje me burimet njerezore dhe financiare që ata janë në gjendje të angazhojnë për këtë Plan.)

Plani gjithashtu thekson rëndësinë e zbatimit të shpejtë në praktike të nismave legjislative të miratuara kohët e fundit, dhe të trainimeve ndergjegjesuese mbi trafikimin dhe ato për rritjen e aftësive, të organizuara për punonjësit e policisë dhe punonjësit e tjere shtetërore.

Ky Plan Veprimi cakton afate kohore dhe tregues rezultatesh realiste për të bërë të mundur arritjen e një përparimi të vazhdueshëm e të matshëm, brenda vlefshmerisë dy-vjecare të Planit. Megjithatë pranohet se qellimi dhe sfidat institucionale të përfshira në shumë prej veprimtarive të planifikuara (psh. venia në zbatim e Planit të Veprimit Kombëtar kundër Trafikut të Femijeve 2005-2007) mund të kërkojnë një kohë me të gjatë për tu vënë në jetë plotësisht, megjithatë shumica e aktivitetëve mund të kryhen me efikasitet brenda afateve kohore të caktuara. Si afatet kohore ashtu dhe nevojat për burime do të ri-vlerësohen rregullisht nga Komiteti Nder-Ministror dhe Grupi i Pikave të Kontaktit gjatë kohezgjatjes së Planit të Veprimit.

## 2. KUADRI STRATEGJIK:

### I. NDJEKJA PENALE

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te rritet numri i ndjekjeve penale te suksesshme, denimeve dhe vendimeve te pershtatshme per trafikuesit e qenieve njerezore, perfshire punonjes te policise dhe zyrtare te tjere shteterore bashkepunetore ne trafiqe dhe krime te lidhura me to:

- **Objektiva Specifike (a):** Te nisen me shume ceshtje dhe te rritet numri i ndjekjeve penale dhe denimeve te trafikuesve ne raport me ndalimet, duke, ndermjet te tjerave, rritur bashkepunimin mes policise dhe prokurorise, dhe te ndermerren hapa per te bere te mundur qe trafikuesit dhe bashkepunetoret e tyre te marrin denimet e merituar.
- **Objektiva Specifike (b):** Te rritet numri i arrestimeve, ndjekjeve penale, denimeve te punonjesve te policise dhe punonjesve te tjere shteterore te cilet kane bashkepunuar ne trafikim, duke, ndermjet te tjerave, rritur bashkepunimin mes policise dhe prokurorise dhe perdorur me gjeresisht denimet penale ne fuqi.
- **Objektiva Specifike (c):** Te rinovohen dhe te shtohen trainimet dhe njohurite profesionale ne lidhje me ndergjegjesimin ndaj trafikut per strukturat e pergjithshme dhe te specializuara te policise, prokurorise dhe gjykatave.
- **Objektiva Specifike (d):** Te vazhdohet te zhvillohet bashkepunimi nderkombetar dhe rajonal ne fushen e zbatimit te ligjit, fushen ligjore dhe ate te drejtesise kunder trafikimit dhe trafikuesve te qenieve njerezore.

### II. MBROJTJA

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te zbatohet nje metode gjithepershiresse per mbrojtjen e viktimave per personat e trafikuar dhe viktimat e krimeve qe kane lidhje me trafikimin, pavaresisht deshires se tyre per te deshmuar apo jo.

- **Objektiva Specifike (a):** Te zbatohet plotesisht Ligji i ri mbi Mbrojtjen e Deshmitarit, te permiresohet mbrojtja ligjore, fizike dhe e identitetit personal per te gjitha viktimat/deshmitaret ne ceshtje gjyqesore, pavaresisht faktit nese bejne pjese apo jo ne Programin per Mbrojtjen e Deshmitareve; si dhe te operacionalizohet plotesisht Programi/Njesia per Mbrojtjen e Deshmitareve per viktimat e trafikut qe jane perzgjedhur.
- **Objektiva Specifike (b):** Te rritet efikasiteti i pergjithshem i perpjekjeve kombetare per identifikimin, referimin dhe ri-integrimin e viktimave duke zhvilluar Qendren Kombetare per Pritjen e Viktimave te Trafikut te Qenieve Njerezore si nje ambient shume-qellimesh per referimin dhe mbrojtjen e viktimave nga Shqiperia dhe nga vende te treta, dhe duke rregulluar pergjegjesite respektive te Qendres Kombetare per Pritjen e Viktimave te Trafikut te Qenieve Njerezore, qendrave te IOM-it dhe asaj "Vatra" te Vlores, strukturave te zbatimit te ligjit dhe te ndihmes sociale, si dhe te OJF-ve partnere, nepermjet nje marreveshjeje per nje Mekanizem Kombetar Referimi, i cili do te pasqyronte praktikat me te mira nderkombetare.

**SYNIME STRATEGJIKE 2:** Te vihet ne zbatim Strategjia Kombetare dhe Plani i Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikimit (I perfshire edhe tek NDJEKJA PENALE dhe PARANDALIMI).

- **Objektiva Specifike:** Te miratohet dhe te filloje venia ne zbatim e projekt-Strategjise Kombetare dhe Planit te Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjen e Femijeve Viktima



te Trafikimit 2005-2007, si eshte parashikuar ne Planin e Veprimit 2003-2004 (Projekt-teksti i bashkangjitur ne Shtojce).

**SYNIME STRATEGJIKE 3:** Te rritet niveli i ndihmes dhe keshillimit zyrtar per te gjitha viktimat shqiptare aktuale apo te mundshme te trafikimit, qe ndodhen jashte Shqiperise.

- **Objektiva Specifike:** Te zgjerohet roli identifikues, mbrojtës dhe ndihmues i punonjesve te Ministrise se Jashtme Shqiptare jashte Shqiperise dhe ne Tirane, dhe te zhvillohet bashkepunimi i tyre me autoritetet perkatese ne vendet kryesore te destinacionit.

### III. PARANDALIMI

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te permiresohen strategjite e qeverise per ndergjegjesim publik, arsimim e informim ne drejtim te shenjestrimit, permbajtjes dhe efikasitetit te tyre, si dhe te zhvillohen e publikohen alternativa profesionale te financuara publikisht, perkundrejt trafikimit e ri-trafikimit.

- **Objektiva Specifike (a):** Te zgjerohen programet e sponsorizuara nga qeveria per arsimin, shtypin dhe menytrat e tjera te informimit, per te informuar dhe mesuar me me shume efikasitet popullaten, sidomos grate, femijet dhe grupet ne rrezik, rreth rreziqeve dhe shkaqeve te trafikimit.
- **Objektiva Specifike (b):** Te zhvillohen nisma me financime publike si dhe nga OJF-te per te organizuar kurse profesionale dhe alternativa te tjera kunder trafikimit dhe ri-trafikimit per grupet ne rrezik.
- **Objektiva Specifike (c):** Te rriten mundesite per perfshirje me te gjere shoqerore te grupeve ne rrezik duke zbatuar ligjin per arsimin e detyrueshem dhe regjistrimin ne zyrat e gjendjes civile, dhe duke ofruar arsimim/trainim profesional kompensues per ata qe kane braktisur shkollen (ne perputhje me projekt-Strategjine dhe Planin e Veprimit 2005-7 per Trafikun e Femijeve).

### IV. BASHKERENDIMI

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te zhvillohet bashkepunimi ndermjet punonjesve te ministrive dhe institucioneve perkatese, OJF-ve dhe Zyres se Ministrit te Shtetit per Koordinim per te permiresuar frytshmerine e venies ne zbatim te Planit Kombetar te Veprimit per Anti-Trafikun, si dhe per te rritur cilesine e raportimit dhe bashkepunimit nderkombetar te Shqiperise ne fushen e anti-trafikut.

- **Objektiva Specifike (a):** Te permiresohet funksionimi i grupit te posacem me Pikat e Kontaktit nga cdo Ministri e institucion i interesuar, i krijuar sipas Planit te Veprimit 2003-2004 per te monitoruar punen ne nivelin nder-institucional ne kohen ndermjet mbledhjeve te Komitetit Drejtues Nder-Ministror per Anti-Trafikun.
- **Objektiva Specifike (b):** Te vihen ne zbatim kerkesat e rishikuara per raportimin statistikor te parashikuara ne kete Plan Veprimi, si nje ndihme e rendesishme per vleresimin e veprimtarise sone, dhe per te permbushur detyrimet kryesore nderkombetare per raportim.
- **Objektiva Specifike (c):** Te permiresohet bashkerendimi i perfaqesimit zyrtar te Shqiperise ne takime nderkombetare dhe rajonale per anti-trafikun, dhe te lehtesohet bashkerendimi i Strategjise Anti-Trafik te Shqiperise me ato te vendeve fqinje dhe te rajonit, si edhe me rekomandimet e organizmave dhe institucioneve nderkombetare.

### 3. KUADRI OPERACIONAL:

#### I. NDJEKJA PENALE

**SYNIME STRATEGJIKE 1: Te rritet numri i ndjekjeve penale te sukseshme, denimeve dhe vendimeve te pershtatshme per trafikuesit e qenieve njerezore, perfshire punonjes te policise dhe zyrtare te tjere shtetore bashkepunetore ne trafike dhe krime te lidhura me to.**

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a):** Te nisen me shume ceshtje dhe te rritet numri i ndjekjeve penale dhe denimeve te trafikuesve ne raport me ndalimet, duke, ndermjet te tjerave, rritur bashkepunimin mes policise dhe prokurorise, dhe te ndermerren hapa per te bere te mundur qe trafikuesit dhe bashkepunetoret e tyre te marrin denimet e merituar.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te mblidhen dhe te perdoren bashkarisht nga policia, prokuroria dhe institucionet e drejtise ligjore statistika te sakta dhe te verifikueshme, ne forme tabelash, mbi arrestimet, ndjekjet penale, denimet e masat e denimit, si dhe te analizohen e ndreqen problemet qe hasen.	PSH/MRP, MD, MPCs, ne bashkepunim me PP.	Mars 2005	Grup pune per bazen e te dhenave nder-institucionale, I ngritur me nje urdher te perbashket te MRP dhe MD per te rene dakort mbi matricen e perbashket statistikore, metodologjine e mblehjes, dhe procedurat e raportimit.  Baza e te dhenave e krijuar dhe raporti I pare tre-mujor I perbashket I hartuar per MSH/Komitetin Drejtues Nder-Ministrot.	Ekzistuese  Ekzistuese
(ii) Te krijohen procedura transparente nder-institucionale, duke vene ne perdorim te plote potencialin per menaxhimin e ceshtjeve qe zoteron Sistemi i Menaxhimit Total te Informacionit (TIMS), i financuar nga SHBA/BE, per te ndjekur ecurine e ceshtjeve te vecanta te trafikimit nga arrestimi ne denim.	PSH/MRP, MD, ne bashkepunim me PP dhe partneret nderkombetare.	Shtator 2005	Baza e te dhenave e kompjuterizuar mbi hyrjen e sistemit TIMS te menaxhimit te ceshtjeve, si dhe perdorimi i bazes se te dhenave-i mundshem per te gjitha institucionet bashkepunuese, ne baze ditore apo sipas kerkesave.	Ekzistuese
(iii) Te nxiten anetaret e OJF-ve publike dhe te autorizuar per te raportuar me shume ceshtje trafikimi ne nivel lokal nepermjet nje policimi ne komunitet me te zhvilluar (perfshire publikimin e numrave te celulareve te zyrtareve te larte), dhe duke leshuar udhezime mbi trajtimin dhe raportimin ne menyre konfidenciale te ketyre informacioneve.	PSH/MRP, OJF-te	Janar 2005  Qershor 2005	Aftesite per ndjekjen dhe analizimin e ceshtjeve-te futura dhe te disponueshme per te gjitha isitucionet bashkepunuese pas instalimit te Sistemit te TIMS per Menaxhimin e Ceshtjeve.  Hartimi dhe publikimi I strategjise se propozuar mbi policimin ne komunitet.  Vleresimi dhe publikimi I rezultateve fillestare te strategjise se policimit ne komunitet ne luften kunder trafikimit te qenieve njerezore; rritja e numrit te telefonateve, etj, te regjistruara nga policia, dhe te numrit te ceshtjeve te trafikimit te hapura mbeshtetur ne informacion konfidencial nga publiku.	Ekzistuese  Ekzistuese

<b>Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor: Ndjekjet Penale dhe Denimet ne Ceshitet e Anti-Trafikimit:</b>			
<p>(iv) T'i raportohen cdo tre muaj Ministrit te Shtetit per Koordinim, ne forme tabelash, dhe te ndara neper kategori sipas akuzave, statistikave e institucioneve per arrestimet, ndjekjet penale, denimet, vendimet e gjykatave dhe apelimet ne ceshitet e trafikut, perfshire te dhena mbi numrin, gjinine, kombesine, moshen dhe statusin e viktimave.</p>	<p>PSH/MRP, MD, MPCs, ne bashkepunim me PP</p>	<p>Mars 2005 e ne vazhdim</p> <p>Qershor 2005</p>	<p>Raporti I pare statistikor I hartuar nga Grupi I Perbashket I Punes per MSH/Komitetin Drejtues Nder-Ministror.</p> <p>Bashkepunim I permiresuar mes policise dhe prokurorise ne ndarjen, hartimin dhe analizimin e te dhenave mbi arrestimet, ndjekjet penale dhe denimet, si dhe ne vleresimin e perbashket te te dhenave; rritje e numrit te ceshtjeve te nisura, si dhe I ndjekjeve penale te suksesshme dhe denimeve te trafikuesve dhe bashkepunetoreve te tyre.</p>
			<p>Ekzistuese</p> <p>Ekzistuese</p>

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (b):** Te rritet numri i arrestimeve, ndjekjeve penale, denimeve te punonjesve te policise dhe punonjesve te tjere shteterore te cilet kane bashkepunuar ne trafikim, duke, ndermjet te tjerave, rritur bashkepunimin mes policise dhe prokurorise dhe perdorur me gjeresisht denimet penale ne fuqi.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te ndermerren hapa per te mundesuar aplikimin e sanksioneve te duhura te Kodit Penal, jo vetem te masave administrative, kunder te gjithe punonjesve te policise, gjykateseve, prokuroreve dhe punonjesve te tjere shteterore te cilet marrin pjese apo lehtesojne trafikimin e qenieve njerezore, dhe te informohet opinioni publik mbi veprimet e ndermarra dhe rezultatet e arritura.	PSH/MRP, Doganat/MF, ne bashkepunim me PP	Shkurt 2005  Mars 2005  Mars 2005 e ne vazhdim	Hartimi dhe nxjerrja e Rregulloreve te Brendshme te cilat detyrojne qe cdo ceshnje ne te cilen ka perfshirje te punonjesve te policise t'i raportohet SHKB-se/MRP per vendim mbi denim penal apo te nje lloji tjetër.  Nxjerrja e Rregulloreve te Brendshme/Udhezimeve paralele nga Ministri apo Institucione te tjera te Linjes.  Raportim i rregullt per Ministrin e Rendit Publik, MSH/Komitetin Drejtues Nder-Ministor, dhe kreret e institucioneve te tjera mbi numrat e procedimeve penale, perkundrejt atyre administrative, te nisura.  Publikimi i statistikave mbi ndjekjet penale te punonjesve shteterore te korruptuar.	Ekzistuese  Ekzistuese  Ekzistuese  Ekzistuese
(ii) Te caktohet nje prokuror prane Sherbimit te Kontrollit te Brendshem ne MRP per te dhene keshilla ligjore mbi proceset qe duhen ndjekur per te mundesuar ndjekje penale me te suksesshme te punonjesve te korruptuar te policise, dhe per te permiresuar ne pergjithesi marredheniet e punes mes SHKB/MRP dhe Prokurorise se Pergjithshme.	MRP, ne bashkepunim me PP	Dhjetor 2005  Dhjetor 2005	Caktimi i nje prokurori per te punuar me kohe te plote prane SHKB-se; rritje e numrit te ndjekjeve penale te suksesshme.	Ekzistuese
(iii) Te publikohet me gjeresisht dhe te perdoret me efektivisht linja telefonike publike e SHKB/MRP per denoncimin e ceshnjeve te korupsionit ne polici, dhe te hartohen programe nxitese per punonjesit e policise dhe punonjes te tjere publike te cilet denoncojne raste korupsioni.	MRP	Mars 2005	Publikim i gjere i numrave telefonike, funksionim i plote i linjave dhe rritje e besimit te publikut dhe e transparences; rritje e numrave te telefonatave te regjistruara nga policia; rritje e numrit te ceshnjeve te trafikimit te nisura mbeshtetur ne informacione konfidenciale nga publiku.	Ekzistuese

<b>Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor: Hetimet, Ndjekjet Penale dhe Denimet e Punonjesve Shteterore:</b>			
<p>(iv) T'i raportohet cdo tre muaj Ministrit te Shtetit per Koordinim/Komitetit Drejtues Nder-Ministror (ne tabela) mbi pushimet nga puna, masat disiplinore/ administrative si dhe ndjekjet penale/denimet e punonjesve te policise, prokurorise, gjykatave apo punonjesve te tjere shteterore te perfshire ne trafikim.</p>	<p>PSH/MRP/SHKB, MD, Ministria e Financave/ Doganat, ne bashkepunim me PP</p>	<p>Mars 2005</p>	<p>Zbatimi I Kerkesave te Rishikuara per Raportim; rritje e numrit te arrestimeve, ndjekjeve penale dhe denimeve te raportuara te punonjesve te policise dhe atyre te tjere shteterore te perfshire ne trafikim te qenieve njeretore; rritje e aplikimit te denimeve penale; permiresim I bashkepunimit mes SHKB-se, njesive te tjera te kontrollit te brendshem, dhe PP in ndjekjen penale te punonjesve te policise dhe punonjesve te tjere shteterore te korruptuar.</p>
			<p>Ekzistuese</p>

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (c):** Te rinovohen dhe te shtohen trainimet dhe njohurite profesionale ne lidhje me ndergjegjesimin ndaj trafikut per strukturat e pergjithshme dhe te specializuara te policise, prokurorise dhe gjykatave.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te institucionalizohen kurse trainimi te detyrueshme per njohuri mbi te drejtat e njeriut dhe viktimat e trafikimit, per te gjitha punonjesit te rolit te pergjithshem ne polici, prokurori dhe gjykata; gjithashtu, te institucionalizohen trainime te perbashketa te nje karakteri me te specializuar per punonjes policie, prokurorie dhe gjykate me detyra specifike ne lidhje me ceshtjet e trafikimit te qenieve njerezore.	MRP, MD, ne bashkepunim me PP e Organizatat Nderkombetare (ON)	Mars 2005  Qershor 2005 e ne vazhdim  Shtator 2005 e ne vazhdim  Dhjetor 2005	Kryerja e nje studimi mbi nevojat per trainime rreth ndergjegjesimit ne ceshtjet anti-trafik dhe mangesite ne strukturat perkatese te PSH, dhe rekomandimi i procedurave per trainime te perbashketa te punonjesve te policise te sektorit te anti-trafikut, prokuroreve dhe gjykatave.  Institucionalizimi i kurrikulumeve ne Akademe dhe Policise dhe Shkollen e Magjistratures mbi ndergjegjesimin per ceshtjet anti-trafik dhe procedurat ligjore; caktimi dhe trainimi i trainuesve, per te siguruar vazhdimesi.  Trainimi i te gjitha te diplomuarve nga Akademia e Policise per ndergjegjesim ne ceshtjet e trafikimit.  Zgjerimi i njohurive per anti-trafikimin dhe rritja e profesionalizmit ne pergjithesi i punonjesve te policise, prokurorise dhe gjykatave.	Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese, e donatoret
(ii) Te ruhet numri i personelit, financimi dhe nivelet e trainimit te Sektorit Anti-Trafik te Drejtorise se Krimet te Organizuar ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit dhe ne drejtorite e qarqeve; si dhe te rekrutohen, trainohen e caktohen me detyra ne kete Sektor me shume punonjese te kualifikuara policie femra.	MRP	Qershor 2005  Qershor 2005  Qershor 2005  Dhjetor 2005	Trainimi apo ri-trainimi, sipas nevojës, i te gjitha punonjesve te policise anti-trafik.  Caktimi i te pakten nje punonjeseje policie femer te trainuar ne te gjitha zyrat rajonale te anti-trafikut, dhe ne Pikat kryesore te Kalimit Kufitar.  Caktimi me ane te nje urdhri te brendshem i periuqes se qendrimit prej te pakten 3 vjetesh ne Sektorin/Zyren rajonale Anti-trafik te stafit te trainuar, per te siguruar vazhdimesi.  Ruajtja e forces dhe financimit te Sektorit Anti-trafik ne PSH/ MRP dhe Zyrat Rajonale, ne nivelet e viteve 2002-2003; rifreskimi dhe rritja e nivelit te trainimit te personelit te Sektorit dhe Zyrave Rajonale; permiresimi i punes se Sektorit dhe Zyrave Rajonale nepermjet caktimit ne te punonjeseve femra, te trainuara.	Ekzistuese, e te reja  Ekzistuese  Ekzistuese, e te reja  Ekzistuese, e te reja

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (d):** Te vazhdohet te zhvillohet bashkepunimi nderkombetar dhe rajonal ne fushen e zbatimit te ligjit, fushen ligjore dhe ate te drejtesise kunder trafikimit dhe trafikuesve te qenieve njerезore.

<b>Aktivitetet</b>	<b>Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendese)</b>	<b>Afati Kohor</b>	<b>Tregues</b>	<b>Burimet</b>
(i) Te vazhdohet te zhvillohet Qendra Anti-Trafik e Vlores (QATV) si nje burim kombetar, rajonal dhe nderkombetar per trainime, analiza dhe shpermdarje informacioni, ne bashkepunim me Gjermanine, Greqine, Italine dhe vende te tjera fqinje.	PSH/MRP, ne bashkepunim me partneret dypalesh dhe nderkombetare.	Mars 2005	Hartimi I nje raporti vleresues mbi punen e QATV ne vitin e saj te pare, dhe mbi kontributin e saj ne hetimet/operacionet e zbulimit dypaleshe, nderkombetare dhe kombetare.	Ekzistuese, partneret dypalesh dhe nderkombetare.
(ii) Te forcohet bashkepunimi ekzistues mes policise shqiptare dhe homologeve te saj ne vendet fqinje duke kryer ushtrime te perbashketa periodike; te hartohen marveshje te reja dypaleshe ne vazhde te atyre ekzistuese me vendet fqinje; dhe te vazhdohet te merret pjese ne ushtrimet rajonale anti-trafik (psh operacionet "Mirazh" te sponsorizuara nga SECI).	PSH/MRP	Mars 2005  Mars 2005	Zhvillimi I nje studimi te brendshem per te gjetur mundesite per permiresimin e bashkepunimit me policite kufitare te vendeve fqinje.  Raportim i rregullt tek MSH/Komiteti Drejtues Nder-Ministor mbi marveshjet e reja te arritura, numrin e ushtrimeve te perbashketa te realizuara, dhe ndjekjet penale qe vijne si rezultat I bashkepunimit nder-kufitar.	Ekzistuese  Ekzistuese
(iii) Te zgjerohet rrjeti I marveshjeve te bashkepunimit nderkombetar e rajonal ne fushen e drejtesise, duke mbuluar fushat e mbrojtjes dhe zhvendosjes se perkohshme te deshmitareve; ndihmes ligjore reciproke; njohjes reciproke te vendimeve gjyqesore; si dhe te ekstradimit.	PSH/MRP, MD, dhe MPJ	Dhjetor 2005	Organizimi I te pakten nje ushtrimi te perbashket/vizite ne vit me secilin prej vendeve fqinje.	Ekzistuese dhe dypaleshe.
(iv) Te vazhdohet te zbatohet Sistemi i Menaxhimit Total te Informacionit (TIMS) i financuar nga SHBA/BE, dhe Sistemi i Informacionit per Kontrollin Kufitar ne te gjitha pikat e kalimit kufitar; te rritet numri i rasteve te ndalimit te perpjekjeve per trafikim apo kalim te paligjshem te kufirit.	PSH/MRP, ne bashkepunim me ICITAP, PAMECA, etj	Mars 2005  Mars 2005	Zhvillimi I nje studimi te brendshem per te identifikuar fushat ku nevojitet permiresim I rrjetit nderkombetar/rajonal ne fushen e drejtesise.  Raportim I rregullt tek MSH/Komiteti Drejtues Nder-Ministor mbi marveshjet ekzistuese dhe te rejat, si dhe rezultatet e arritura.	Ekzistuese  Ekzistuese
(v) Te ruhet rezultati i operacionit te korrikut 2002 ne Vlore kunder trafikimit te shpejte pertej Adriatikut, nepermjet bashkerendimit te vazhdueshem mes njesive kufitare detare te vendit dhe rajonit.	MRP, MM	Mars 2005, e ne vazhdim	Zbatimi I fazave 1 dhe 2 te programit te Menaxhimit te Kufijve nga TIMS; hartimi i raportit te pare 3-mujor per MSH/Komitetin Drejtues Nder-Ministor, duke treguar vlerat e venies ne zbatim te TIMS.	Ekzistuese, te reja e donatoret
		Dhjetor 2005	Zhvillimi i te pakten nje ushtrimi te perbashket detar me vendet fqinje ne vit; ruajtja e nivelit te larte aktual te ndalimit te perpjekjeve per trafikim.	Ekzistuese



<b>Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor: Bashkepunimi Nderkombetar i Institucioneve te Zbatimit te Ligjit dhe Drejtesise Ligjore:</b>					
(vi) T'i raportohet cdo tre muaj Ministrit te Shtetit per Koordinim/Komititetit Drejtues Nder-Ministor mbi rezultatet e hetimeve dhe ndjekjeve penale te dala nga aktivitetet e QATV, ne Shqiperi dhe jashte saj.	PSH/MRP, ne bashkepunim me PP	Mars 2005, e ne vazhdim	Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; demonstrimi i kontributit te QATV-se ne bashkepunimin rajonal e kombetar ne fushen e informacionit.	Ekzistuese	
(vii) Te raportohet tek Ministri i Shtetit per Koordinim/Komititetit Drejtues Nder-Ministor cdo tre muaj, ne forme tabelash, dhe ne baze te kategorive te akuzave, mbi arrestimet, ndjekjet penale, denimet dhe vendimet qe jane rezultat i operacioneve anti-trafik dypaleshe/rajonale/nderkombetare ose operacione kombetare te drejtuara kunder trafikut.	PSH/MRP, MD, ne bashkepunim me PP	Mars 2005, e ne vazhdim	Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; demonstrimi I kontributit te Shqiperise ne fushen nderkombetare te zbatimit te ligjit.	Ekzistuese	
(viii) T'i raportohet Ministrit te Shtetit/Komititetit Drejtues Nder-Ministor cdo tre muaj mbi rezultatet e hetimeve dhe ndjekjeve penale te dala nga venia ne zbatim e Sistemit te te Informacionit te Kontrollit Kufitar te TIMS ne fushen e anti-trafikut.	PSH/MRP, MD ne bashkepunim me PP	Mars 2005 e ne vazhdim	Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; demonstrimi I vleres se venies ne zbatim te TIMS.	Ekzistuese	
(ix) T'i raportohet Ministrit te Shtetit/Komititetit Drejtues Nder-Ministor cdo tre muaj mbi hartimin dhe zbatimin e Marreveshjeve per Ndhimen Ligjore Reciproke, ato Dypaleshe e Shumepaleshe per Ekstradimin, etj, me vendet fqinje e te tjera ne ceshtje te lidhura me trafikimin; te raportohen edhe mbi ndjekjet penale dhe denimet e dala si rezultat I tyre, ne Shqiperi dhe jashte saj.	MD, ne bashkepunim me PP	Mars 2005 e ne vazhdim	Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; demonstrimi I kontributit te Shqiperise ne bashkepunimin kombetar e nderkombetar ne fushen ligjore dhe ate te drejtesise penale.		



## II. MBROJTJA

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te zbatohet nje metode gjithepershiresse per mbrojtjen e viktimave per personat e trafikuar dhe viktimat e krimeve qe kane lidhje me trafikimin, pavaresisht deshires se tyre per te deshmuar apo jo.

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a):** Te zbatohet plotesisht Ligji i ri mbi Mbrojtjen e Deshmitarit, te permiresohet mbrojtja ligjore, fizike dhe e identitetit personal per te gjitha viktimat/deshmitaret ne ceshije gjyqesore, pavaresisht faktit nese bejne pjese apo jo ne Programin per Mbrojtjen e Deshmitareve; si dhe te operacionalizohet plotesisht Programi/Njesia per Mbrojtjen e Deshmitareve per viktimat e trafikut qe jane perzgjedhur.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te hartohen dhe vihen ne zbatim akte nenligjore qe rregullojne funksionimin e Njesise nder-institucionale per Mbrojtjen e Deshmitarit prane MRP, te plotesuar me personel dhe fonde, sic parashikohet ne Ligjin per Mbrojtjen e Deshmitareve.	MD, MRP, MPCS, ne bashkepunim me PP e me ndihme nderkombetare	Mars 2005  Dhjetor 2005 e ne vazhdim.	Zbatimi i akteve nenligjore, miratimi i fondeve dhe personelit, funksionimi i Programit per Mbrojtjen e Deshmitarit.  Njesia per Mbrojtjen e Deshmitarit nxjerr raportin e pare per Ministrin e Shtetit/Komitetin Drejtues Nder-Ministrot mbi numrat e ceshtjeve dhe te deshmitareve qe perfitojne nga Programi per Mbrojtjen e Deshmitarit.  Rritje ne numrin e viktimave qe pranojne te deshmojne, dhe ne numrin e gjykimeve te suksesshme te trafikuesve si rezultat i Programit/Njesise per Mbrojtjen e Deshmitarit.	Ekzistuese, e te reja
(ii) Te jepet ndihme ligjore dhe mbrojtje fizike dhe e te dhenave personale per te gjitha viktimat/deshmitaret e trafikut dhe OJF-te e autorizuar per mbeshtetjen e viktimave, perfshire krijimin e kushteve teknike per mbrojtje e siguri gjate gjyqesve ne Paketën Ligjore "Anti Mafia" te vitit 2004.	MD, MF	Qershor 2005	Pajisja e te pakten nje Gjykate per Krimet e Renda me elementet e duhur teknike per mbrojtje dhe siguri; rritje e numrit te viktimave te gatshme per te deshmuar, dhe e numrit te denimeve te suksesshme te trafikuesve, si rezultat i krijimit te kushteve te sigurta dhe procedurave te tjera te ngjashme gjate gjykimit.	Ekzistuese, te reja dhe donatoret
(iii) Te ndertohtet nje skeme shteterore kompensimi per kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave te trafikut te qenieve njerezore, bazuar, nder te tjera, tek konfiskimi i pasurive te trafikuesve; si dhe te jepet asistence ligjore falas per te ndihmuar viktimat te fitojne kompensim permes kesaj skeme, qofshin apo jo pjese e Programit te Mbrojtjes se Deshmitarit.	MF, PSH/ MRP, ne bashkepunim me PP dhe MD	Qershor 2005  Janar 2006	Miratimi dhe Financimi i Skemes Shteterore per Kompensim, dhe informimi i publikut, viktimave dhe juristeve per menytrat e shfrytezimit te saj.  Nxjerrja e nje raporti per Ministrin e Shtetit per Koordinim/Komitetin Drejtues Nder-Ministrot me numrat e viktimave qe perfitojne nga Skema, si dhe shumat e shperndara tek ta; rritja e numrit te viktimave qe pranojne te deshmojne kunder trafikuesve, si rezultat i Skemes.	Ekzistuese (plus pasuri te konfiskuara, fonde te reja dhe donatoret)  Ekzistuese
(iv) Te ofrohet training per njohuri mbi te drejtat e njeriut per punonjesit e medias, per t'i sensibilizuar raportimet e tyre te ceshtjeve te trafikimit te qenieve njerezore, sidomos duke u perqendruar tek nevoja per te mbrojtur dhe respektuar identitetin dhe te drejten per jete private te personave te trafikuar, vecanerisht te atyre qe deshmojne kunder trafikuesve te tyre.	OJF, ON, MSH	Qershor 2005	Organizimi i nje tryeze te rrumbullaket per punonjesit e medias me asistence te Organizatave Nderkombetare dhe OJF-ve; raportin me sensitiv dhe ne perputhje me ligjin mbi ceshtjet e trafikimit nga ana e medias, si rezultat i kesaj tryeze.	Ekzistuese, e donatoret

**Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor: Mbrojtja e Viktimave dhe Viktimave/Deshmitare:**

<p>(v) Te raportohet tek Ministri I Shtetit per Koordinim/Komiteti Drejtues Nder-Ministor cdo tre muaj ne forme tabelash mbi (1) numrin e deshmitareve dhe viktimave/deshmitare qe deshmojne ne Gjykatat e Krimeve te Renda (GJKR) dhe ato te Rretheve; (2) numrin e deshmitareve dhe viktimave/deshmitare te trafikimit qe jane pranuar ne Programin afatgjate per Mbrojtjen e Deshmitarit (PMD) dhe (3) numrin e deshmitareve dhe viktimave/deshmitare te trafikimit te cilet kane terhequr deshmitare e tyre gjate seancave gjyqesore, si dhe arsyet pse jane terhequr.</p>	<p>PSH/MRP, MPCs, MD, ne bashkepunim me PP</p>	<p>Mars 2005</p> <p>Qershor 2005 e ne vazhdim</p>	<p>Pergatitja dhe miratimi I nje tabele raportimi te perbashket nga institucionet e perfshira; marrja e te dhenave te sakta dhe ne kohen e duhur.</p> <p>Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; ndikim I dukshem I ndryshimeve legjislative dhe proceduriale tek numri I viktimave qe pranojne te deshmojne.</p>	<p>Ekzistuese</p>
<p>(vi) Te raportohet cdo tre muaj tek Ministri I Shtetit per Koordinim/Komiteti Drejtues Nder-Ministor mbi hapat e ndermarre per te instaluar e perdorur masat teknike mbrojtese te parashikuara ne ligjet mbi GJKR, Anti-Mafia dhe Mbrojtjen e Deshmitareve.</p>	<p>MD, ne bashkepunim me PP</p>	<p>Dhjetor 2005 e ne vazhdim</p>	<p>Zbatimi i Kerkesave te Rishikuara per Raportim; ndikim I dukshem I ndryshimeve legjislative dhe proceduriale tek numri I viktimave qe pranojne te deshmojne.</p>	<p>Ekzistuese</p>

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (b):** Te rritet efikasiteti i pergjithshem i perpjekjeve kombetare per identifikimin, referimin dhe ri-integrimin e viktimave duke zhvilluar Qendren Kombetare per Pritjen e Viktimave te Trafikut te Qenieve Njerezore si nje ambient shume-qelimesh per referimin dhe mbrojtjen e viktimave nga Shqiperia dhe nga vende te treta, dhe duke rregulluar pergjegjesite respektive te Qendres Kombetare per Pritjen e Viktimave te Trafikut te Qenieve Njerezore, qendrave te IOM-it dhe asaj “Vatra” te Vlores, strukturave te zbatimit te ligjit dhe te ndihmes sociale, si dhe te OJF-ve partnere, nepermjet nje marreveshjeje per nje Mekanizem Kombetar Referimi, i cili do te pasqyronte praktikatat me te mira nderkombetare.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendese)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te krijohet e vihet ne zbatim nje Mekanizem Referues Kombetar mes te gjitha aktoreve kombetare te perfshire ne kontrollin fillestar dhe pritjen, mbrojtjen e ri-integrimin e viktimave te trafikimit te kapura e te kthyer, bazuar tek nje Memorandum Mirekuptimi qe percakton pergjegjesite dhe te drejtat respektive te qeverise, OJF-ve, strukturave te asistences per viktimat dhe atyre te agjencive te zbatimit te ligjit.	PSH/MRP, MPCS, ne bashkepunim me PP, ON dhe OJF-te	Janar 2005 Mars 2005 Qershor 2005 Janar 2006	Tryeze e rumbullaket e organizuar me asistence nderkombetare per te finalizuar projekt-Memorandumin e Mirekuptimit per Mekanizmin Kombetar Referues. Miratimi nga te gjitha palet ne MKR/MM I drejtimet kritik dhe rrjedhes se veprimeve; ndarja e roleve dhe pergjegjesive, si dhe percaktimi i procedurave te raportimit. Hartimi dhe firmosja e MM nga te gjithe partneret shteterore dhe OJF. Permiresim i pergjithshem i efektivitetit te perpjekjeve kombetare per identifikimin, referimin dhe rintegrimin e viktimave, si rezultat i MKR/MM.	Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese, te reja e donatoret (perfshire OJF-te e autorizuar dhe koalicionet e OJF-ve) (programi CAAHT)  Ekzistuese, te reja e donatoret (perfshire OJF-te e autorizuar dhe koalicionet e OJF-ve) (programi CAAHT)
(ii) Te sigurohet nje identifikim dhe dokumentim fillestar me efikas i viktimave ne pikat kryesore te kthimit duke pergatitur nje pyetesor standart per perdorim nga te gjitha punonjesit e agjencive te zbatimit te ligjit; si dhe duke nxjerre direktiva per agjencite e zbatimit te ligjit dhe punonjes te tjere shteterore ne lidhje me procedurat qe duhen ndjekur gjate referimit te viktimave te identifikuar apo personave te dyshuar si viktimat per ne qendra apo sherbime te tjera qe ofrojne asistence e mbeshtetje per viktimat.	PSH/MRP, MPCS, ON dhe OJF-te	Dhjetor 2004- Qershor 2005 Janar 2005 Dhjetor 2005	Zbatimi i procedurave fillestare te pritjes dhe referimit sipas MKR/MM, fillimisht ne Aeroportin Nderkombetar te Rinasit, e me vone ne te gjitha pikat kryesore te kalimit te kufirit. Hartimi me ndihmen e nderkombetareve dhe perdorimi i nje pyetesori te standartizuar per te kthyer/viktimat, ne te gjitha pikat e kalimit kufitar, etj, per te ndihmuar ne identifikimin e personave te dyshuar si viktimat te trafikimit. Zhvillimi i kontrolleve te papritura per te verifikuar nivelin e njohurive te punonjesve te policise etj mbi procedurat e referimit; procedura fillestare te permiresuara te identifikimit dhe referimit/ndermarrja e veprimeve korrigjuese.	Ekzistuese, te reja e donatoret  Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
<p>(iii) Te plotesohet me personel e te perdoret Qendra Pritese Kombetare e drejtuar nga qeveria per te siguruar strehim te perkohshem te sigurte, ndihme psikologjike/shendetesore, per viktimat shqiptare dhe ato nga vendet e treta, perpara ri-integrimit apo riadhesimit, ose per periudhen kohore gjate se ciles ato bashkepunojne me sistemin e drejtesise.</p>	<p>MPCS, PSH/MRP, ON, OJF</p>	<p>Shkurt 2005  Prill 2005  Janar 2006</p>	<p>Kryerja e nje studimi mbi nevojat per personel e burime te Qendres Pritese kombetare, ne vazhde te kerkesave te Mekanizmit Kombetar Referues, Memorandumit te Mirekuptimit, Programit per Mbrojtjen e Deshmitarit, Strategjise Kombetare kunder Trafikimit te Femijeve.</p> <p>Kompletimi me personel dhe pershtatja e Qendres Kombetare Pritese me nevojat e kohes; trainim shtese i personelit.</p> <p>Vleresim pozitiv nga ana e perfituesve per cilesine e sherbimeve te ofruara nga QKP (dhe streha te tjera te autorizuar); arritje e rezultateve dhe shkurtrim i kohegjatjes se qendrimit nen perkujdesje perpara ri-integrimit.</p>	<p>Ekzistuese, e donatoret.</p> <p>Ekzistuese, te reja e donatoret</p> <p>Ekzistuese, e donatoret</p>
<p>(iv) Te mbeshteten aktivitetet e Qendres "Vatra" ne Vlore dhe qendrave ri-integruese te OJF-ve te tjera, si nje pjese integrale e Mekanizmit Kombetar Referues, duke kombinuar financimet e donatoreve dhe te qeverise.</p>	<p>MPCS, MF</p>	<p>Maj 2005</p>	<p>Miratimi i subvencionimit nga qeveria e qendres "Vatra" ne Vlore, dhe e qendrave te tjera te OJF-ve, ne perputhje me projekt-ligjin mbi financimin publik te OJF-ve te sherbimit social, dhe ne perpjestim te drejte me numrin e personave te ndihmuar prej tyre.</p>	<p>Ekzistuese, te reja e donatoret (perfshi Programin CAAHT)</p> <p>Ekzistuese, e te reja</p>
<p>(v) Te nxitet zhvillimi ne nivel kombetar i koalicioneve rajonale te OJF-ve/qendrave ri-integruese lokale kunder trafikimit, policise/prokurorise anti-trafik, dhe sherbimeve sociale, bazuar tek ai ekzistues ne 4 prefekturat jugore.</p>	<p>PSH/MRP, MPCS, ne bashkepunim me PP, ON dhe OJF-te</p>	<p>Janar 2005  Dhjetor 2005</p>	<p>OJF-te rajonale ftohen te marrin pjese ne Tryezen e Rrumbullaket te Mekanizmit Kombetar Referues, dhe te firmosin, nese jane te pershtatshme, Memorandumin e Mirekuptimit te Mekanizmit Kombetar Referues.</p> <p>Krijimi dhe njohja zyrtarisht e koalicioneve te tjera te OJF-ve rajonale, perfshire komunitetet fetare e te tjera te cilet ofrojne ndihme per perfitues nga grupe ne rrezik e te vecuara nga shoqeria.</p>	<p>Ekzistuese e donatoret (perfshire Programin CAAHT)</p> <p>Ekzistuese e donatoret (perfshire Programin CAAHT)</p>
<p>(vi) Te hartohen programe per te siguruar ndihme te pershtatshme pas daljes nga qendra, duke mbeshtetur, mbrojtur e ri-integruar te gjitha viktimat e identifikuar, perfshire dhenien e mundesise per te perfutur nga sherbimet keshilluese/shendetesore, dhe kurset per arsim apo trainim profesional e te tjera aftesi te nevojshme ne jete.</p>	<p>MPCS, PSH/MRP, ON e OJF-te</p>	<p>Qershor 2005</p>	<p>Krijimi dhe financimi i nje mekanizmi konfidencial si pjese e MKR per monitorim dhe sigurim te benefiteve shoqerore/papunesie per persona qe kane qene viktimat te strehuara, si dhe per keshillim mbi mundesite e integrimit, perfshire ketu keshillim nga persona me histori te njejte, bashkim familje dhe gjetje vendesh pune.</p>	<p>Ekzistuese, te reja e donatore.</p>

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
<p>(vii) Te krijohet nje linje telefonike kombetare, falas, per ndihme per viktimat e trafikimit dhe familjet e tyre, bazuar ne ekspertizen e qendrave dhe strehave ri-integruese, partnereve nderkombetare e atyre nga OJF-te mbi mbrojtjen e viktimave dhe lidhjen ne nje rrjet te agjencive te zbatimit te ligjit.</p>	<p>MPCS, MRP, MPJ, ne bashkepunim me ON dhe OJF-te</p>	<p>Mars 2005</p> <p>Qershor 2005</p> <p>Dhjetor 2005</p>	<p>Mbajtja e nje seminari ne Tirane me ndihme nderkombetare, duke bashkuar ne nje vend partneret kombetare te mundshem te linjes telefonike SOS dhe OJF-te rajonale e nderkombetare me pervojte ne krijimin dhe drejtimin e linjave te tilla telefonike.</p> <p>Arrija e marreveshjeve ne kontekst te Memorandumit te Mirekuptimit te Mekanizmit Kombetar Referues me OJF-te kombetare e rajonale per te krijuar e drejtuar linjen telefonike kombetare SOS, bazuar ne ekspertizen ekzistuese te qendrave ri-integruese;</p> <p>Sigurimi i asistences nderkombetare per te trainuar personelin e linjes telefonike dhe per te lehtesuar kontaktet nderkombetare.</p> <p>Funksionimi i linjes kombetare SOS, ne bashkepunim me institucionet shteterore perkatese, OJF-te dhe linja te tjera ndihme dhe sherbime konsullore ne vendet kryesore te destinacionit; rritje e numrit te viktimave/viktimave te mundshme te riatdhesuara nepermjet kontakteve OJF-Konsullata.</p>	<p>Ekzistuese, e donatoret.</p> <p>Ekzistuese, te reja e donoret (perfshi Programin CAAHT)</p> <p>Ekzistuese, te reja e donoret (perfshi Programin CAAHT)</p>
<p>(viii) Te vihen ne zbatim akte nenligjore per te zyrtarizuar nxjerrjen e Lejeve te Perkohshme te Qendrimit per viktime te trafikimit nga vende te treta te cilet deshirojne te qendrojne te strehuar ne qendra ne Shqiperi per arsye ligjore apo riaftesuese.</p>	<p>PSH/MRP, MPKS, ne bashkepunim me MD</p>	<p>Mars 2005</p> <p>Mars 2005</p> <p>Qershor 2005</p>	<p>Nxjerrja e udhezimeve per te krijuar dhe financuar nje zyre brenda MRP per te administruar procedurat e lejeve te perkohshme te qendrimit.</p> <p>Hartimi dhe miratimi i akteve nenligjore te duhura.</p> <p>Leshimi i lejeve te perkohshme te qendrimit ne perputhje me procedurat ligjore dhe administrative.</p>	<p>Ekzistuese e te reja</p> <p>Ekzistuese</p> <p>Ekzistuese</p>

<b>Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor: Mekanizmi Kombetar Referues:</b>				
(ix) Te raportohet cdo tre muaj tek Ministri I Shtetit per Koordinim/Komiteti Drejtues Nder-ministor mbi te gjitha shtetasit shqiptare apo te vendeve te treta te strehuar neper qendra: sipas moshes dhe gjinise, vendit te arrestimit apo trafikimit; kohes aktuale apo asaj te pritsme te qendrimit ne qender, statusit te deshmitarit apo te personit me leje qendrimi te perkohshme, dhe duke dalluar mes viktimave/ceshtjeve te reja dhe atyre te perseritura.	Qendra Kombetare per Pritjen e Viktimave te Trafikimit te Qenieve Njerezore, MPCs, ne bashkepunim me IOM, "Vatra"-n e Vlores, pjesetare te tjere te Memorandumit te Mirekuptimit/Mekanizmit Kombetar Referues dhe PSH/MRP	Mars 2005	Arrijta e marreveshjes mes MPCs, IOM, qendres "Vatra" te Vlores dhe pjesetareve te tjere te licensuar te Memorandumit te Mirekuptimit/Mekanizmit Kombetar Referues, mbi procedurat per raportimin e perbashket te statistikave.	Ekzistuese
(x) Te raportohet cdo tre muaj ne forme tabelash mbi numrin e qytetareve shqiptare, te rritur dhe te mitur, te kthyer ne pikat kryesore te kalimit te kufirit, te cilet jane identifikuar apo dyshohen si te trafikuar, si dhe menyren e perpunimit te tyre.	PSH, MRP, MPCs	Janar 2005	Zbatimi i kerkesave per raportim; krijimi i bazes se te dhenave zyrtare statistikore me numrat e viktimave te kthyer te identifikuar e te referuara.	Ekzistuese

**SYNIME STRATEGJIKE 2: Te vihjet ne zbatim Strategjia Kombetare dhe Plani i Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikimit (I perfshire edhe tek NDJEKJA PENALE dhe PARANDALIMI).**

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a):** Te miratohet dhe te filloje venia ne zbatim e projekt-Strategjise Kombetare dhe Planit te Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikimit 2005-2007, si eshte parashikuar ne Planin e Veprimit 2003-2004 (Projekt-teksiti i bashkangjitur ne Shtojce).

<b>Aktivitetet</b>	<b>Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendese)</b>	<b>Afati Kohor</b>	<b>Tregues</b>	<b>Burimet</b>
(i) Te finalizohet e te dorezohet per miratim tek Keshilli I Ministrave projekt-Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombetar per Luften kunder Trafikut te Femijeve dhe per Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikut 2005-2007.	MSH	Janar 2005	Miratimi nga qeveria i Planit te Veprimit	Si tek Plani i Veprimit Kunder Trafikimit te Femijeve



(ii) Te krijohet nje strukture nder-institucionale Kombetare per Mbrojtjen e Femijeve, ne nivel qendror dhe ate te prefekturave, ashtu sic parashikohet ne projekt-Strategjine dhe Planin e Veprimit Kombetar kunder Trafikimit te Femijeve 2005-2007.	MPCS, MPVD, MSH, On e OJF	Mars 2005 Mars 2005 Qershor 2005	Miratimi Nga Qeveria I Rregulloreve Dhe Akteve Nenligjore Perkatese. Krijimi Dhe Funksionimi Ne Nivel Qendror I Struktures Kombetare Per Mbrojtjen E Femijeve. Krijimi dhe Funksionimi I strukturate perkatese per Mbrojtjen e Femijeve ne nivel prefekturash, duke perfshire te gjitha partneret shtetore, ata nga ON-e dhe OJF-te.	Ekzistuese Te reja, e donatoret Ekzistuese, te reja e donatoret (perfshi Programin CAAHT)
(iii) Te krijohet "Autoritete pergjegjese" paralele, sipas projekt-Marreveshjes se Bashkepunimit me Greqine, per te perpunuar ceshtjet e referuara te femijeve te trafikuar me vendet fqinje e vende te tjera.	MPCS, PSH/ MRP, MPVD, MSH, MPJ, ON e OJF	Janar 2005 Prill 2005	Krijimi i autoritetit pergjegjese ne MPCs per kontaktet nderkombetare, me homologet perkates shtetore e nga OJF-te ne nivelin e prefekturave. Renie dakort mes te gjitha partnereve qeveritare dhe nga OJF-te mbi procedurat standarte te veprimit per kthimin vullnetar te asistuar dhe ri-integrimit e viktimave.	Ekzistuese, te reja e donatoret Ekzistuese, te reja e donatoret
(iv) Te vendoset statusi dhe perberja e Grupit Kombetar te Punes te Luften Kunder Trafikut te Femijeve, sic parashikohet ne projekt-Planin e Veprimit Kombetar kunder Trafikut te Femijeve, per te monitoruar dhe raportuar rregullisht mbi zbatimin tek Ministri I Shtetit per Koordinim dhe Grupi Drejtues Nder-Ministor per Anti-Trafikun.	MPCS, PSH/ MRP, MSH etj.	Janar 2005 Mars 2005	Miratimi nga qeveria i perberjes se Grupit te Punes dhe i rregulloreve perkatese, si dhe aktivizimi i Grupit te Punes. Raportimi i pare tek Ministri i Shtetit per Koordinim/Komiteti Drejtues Nder-Ministor nga Grupi i Punes.	Ekzistuese Ekzistuese
(v) Te perfundohet dhe te firmoset projekt-Marreveshja per Bashkepunim me Greqine per mbrojtjen dhe Kthimin Vullnetar te Ndihtuar te femijeve shqiptare te pashoqeruar, ne rrezik dhe/ose te trafikuar.	MPJ, MPCs, etj.	Janar 2005	Firmosja dhe venia ne zbatim e Marreveshjes se Bashkepunimit me Greqine, pas fillimit te ndjekjes se procedurave te brendshme perkatese.	Ekzistuese
(vi) Te vazhdohet te forcohen marredheniet e punes me qeverite e Greqise dhe shteteve te tjera per te krijuar mekanizma funksionale per mbrojtjen, riatdhesimin dhe ri-integrimit e viktimave femije shqiptare.	MSH, MRP, MPJ, ne bashkepunim me ON, OJF	Mars 2005 e ne vazhdim Nentor 2005 Dhjetor 2005	Bisedime me vendet fqinje dhe ato kryesore te destinacionit per marreveshje te tjera bashkepunimi, dhe krijimi i kontakteve mes Autoritetit Pergjegjese dhe vendeve kryesore te destinacionit. Mbatja e takimit te pare te perbashket me autoritetet greke per te vleresuar rezultatet fillestare te Marreveshjes se Bashkepunimit ne fushat e zbatimit te ligjit, kthimit vullnetar te asistuar dhe integritimit/ri-integrimit. Raport per Ministrin e Shtetit per Koordinim/Komitetin Drejtues Nder-Ministor mbi numrat e viktimave te kthyer nga Greqia dhe vende te tjera kryesore te destinacionit, is dhe rezultatet e integritimit.	Ekzistuese, e te reja. Ekzistuese Ekzistuese

**SYNIME STRATEGJIKE 3: Te rritet niveli i ndihmes dhe keshillimit zyrtar per te gjitha viktimat shqiptare aktuale apo te mundshme te trafikimit, qe ndodhen jashte Shqiperise.**

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a) :** Te zgjerohet roli identifikues, mbrojtës dhe ndihmues i punonjesve te Ministrise se Jashtme Shqiptare jashte Shqiperise dhe ne Tirane, dhe te zhvillohet bashkepunimi i tyre me autoritetet e vendit prites ne vendet kryesore te destinacionit.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
<p>(i) Trainimi I punonjesve te MPJ ne Tirane dhe ne ambasadat e konsullatave shqiptare ne vendet kryesore te destinacionit per: dhenien e sherbimeve te duhura konsullore dhe keshillave viktimave dhe personave te rrezikuar te cilet ndodhen jashte vendit; gjithashtu per nje bashkepunim me te frytshem me autoritetet e vendit ku punojne per identifikimin, mbrojtjen dhe lehtesimin e kthimit te viktimave apo personave te rrezikuar te kthehen ne viktima; si dhe per nderfidhjen me strukturat per mbrojtjen e viktimave te OJF-ve kombetare apo te huaja.</p>	<p>MPJ, ne bashkepunim me MPCs, PSH/MRP, ON, OFJ-te dhe ambasadat.</p>	<p>Prill 2005  Tetor 2005  Dhjetor 2005    Mars 2006</p>	<p>Organizimi i nje seminari ne Tirane per punonjesit e konsullatave te MPJ, me eksperte te huaj dhe ambasadat perkatese, rreth praktikave me te mira per identifikim e referim.  Mbatja e takimeve pasuese ne vendet kryesore te destinacionit mes punonjesve te konsullatave shqiptare dhe autoriteteve e OJF-ve vendase.  Permirsimi i kontakteve formale dhe joformale mes punonjesve te konsullatave shqiptare dhe strukturave te zbatimit te ligjit dhe te OJF-ve kombetare per mbeshtetjen e viktimave ne vendet kryesore te destinacionit, per te ndihmuar viktimat shqiptare te trafikimit, dhe per te lehtesuar kthimin e tyre te rregullt e te asistuar (se bashku me nismat e Mekanizmit Kombetar te Referimit dhe te Linjes Telefonike Kombetare SOS te permendura me lart).</p> <p>Rritja e njohurive te punonjesve shqiptare dhe atyre te vendeve kryesore te destinacionit mbi mekanizmat e referimit qe funksionojne ne Shqiperi; ulje e numrit te viktimave te kthyer pa njoftim paraprak dhe aktivizim te procedurave te ndihmes dhe referimit; ulje e numrit te viktimave te kthyer pa perfshirje te institucioneve kombetare dhe nderkombetare te ndihmes.</p>	<p>Ekzistuese, te reja e donatoret  Ekzistuese, donateret e dypaleshe.  Ekzistuese, donateret e dypaleshe.    Ekzistuese, donateret e dypaleshe.</p>
<p>(ii) Pergatitja e nje fletepalosjeje ne shqip dhe anglisht per tu shperndare nga ambasadat dhe konsullatat shqiptare jashte vendit, konsullatat e vendeve kryesore te destinacionit ne Tirane, si dhe autoritetet kufitare shqiptare ne pikat kryesore te daljes, ku te jepen rreziqet e trafikimit dhe masat e denimit per te, te publikohen linjat telefonike falas te ndihmes dhe numrat e telefonit te strehave evropiane dhe kombetare, adresat dhe numrat e telefonave te ambasadave dhe konsullatave shqiptare, si dhe te pershkruhen ndihma dhe mbeshtetja qe mund tu ofrohen ne shkalle kombetare apo nderkombetare viktimave apo personave te rrezikuar te kthehen ne viktima.</p>	<p>MSh, MPJ, MPCs, PSH/MRP, ON, OJF-te dhe ambasadat.</p>	<p>Mars 2005  Qershor 2005</p>	<p>Organizimi i nje seminari ne Tirane me pjesemarrjen e organizatave nderkombetare, ambasadave te vendeve perkatese dhe ministrive te linjes per te diskutuar dhe rene dakort mbi permbajtjen, pamjen dhe financimin e fletepalosjes informative per anti-trafikun ne gjuhet shqip dhe anglisht.  Porositja, botimi dhe shperndarja e fletepalosjeve nga sherbime zyrtare dhe OJF-te ne Shqiperi e jashte saj.</p>	<p>Ekzistuese, e donatoret  Ekzistuese, e donatoret</p>



### III. PARANDALIMI

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te permiresohen strategjite e qeverise per ndergjegjesim publik, arsimim e informim ne drejtim te shenjestrimit, permbajtjes dhe frytshmerise se tyre, si dhe te zhvillohen e publikohen alternativa profesionale te financuara publikisht, perkundrejt trafikimit e r-trafikimit.

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a):** Te zgjerohen programet e sponsorizuara nga qeveria per arsimin, shtypin dhe menytrat e tjera te informimit, per te informuar dhe mesuar me me shume efikasitet popullaten, sidomos grate, femijet dhe grupet ne rrezik, rreth rreziqeve dhe shkaqeve te trafikimit.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te hartohen programe te reja te sponsorizuara nga qeveria per median dhe mjetet e tjera te ndergjegjesimit publik ku te pershruhen rreziqet e trafikimit te qenieve njerezore, shkaqet qe cojne ne te dhe ceshtje te tjera sociale te lidhura me te (perfshire dhunen familjare kunder grave dhe femijeve, dhunen seksuale, ofertat e rreme per punesim apo martese, korrupsionin zyrtar, diskriminimin racor e gjinor, si dhe shendetin seksual (Semundjet Seksualisht te Transmetueshme, HIV/SIDA) ) dhe te publikohen alternativat arsimore e profesionale perkundrejt trafikimit dhe shfrytezimit te femrave/femijeve.	MPCS, MASH, MSH, ON, OJF-te dhe perfaqesuesit e mediate	Shkurt 2005  Prill 2005  Qershor 2005  Dhjetor 2005  Qershor 2006	Organizimi i nje takimi pune per vleresimin e nevojave, me ndihmen e organizatave nderkombetare/donatoreve, per te diskutuar dhe rene dakort mbi synimet perparimore te fushatave sensibilizuese te ardhshme per median/publikun.  Pergatitja dhe venia ne zbatim e fushatave sensibilizuese per median/publikun me ndihmen e organizatave nderkombetare/donatoreve, duke perfshire median, sistemin arsimor dhe grupet e fokusit te OJF-ve.  Perfitimi i hapësirave publicitare falas ne shtypin elektronik dhe te shkruar shqiptar per te shfaqur materialet per sensibilizim publik te rena dakort me siper.  Rritja e numrit te lajmerimeve ne sherbim te publikut te shfaqura ne mediat shqiptare ne krahasim me vitin 2003-2004, mbi ceshtje te trafikimit, dhunes ne familje dhe ceshtje te tjera te lidhura me gjinine.  Kryerja e nje studimi mbi anetare te grupeve nen fokus per te identifikuar nivelin e njohurive mbi ceshtjet e trafikimit pas perfundimit te fushatave te sensibilizimit, per ta krahasuar ne raport me studimet e meparshme.	Ekzistuese, te reja e donatoret  Ekzistuese, te reja e donatoret (perfshi Programin CAAHT)  Donatoret  Donatoret  Donatoret

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
<p>(ii) Te futet si rryme e pergjithshme Ndergjegjesimi mbi Trafikimin ne te gjitha lendet qe kane te bejne me ndergjegjesimin gjinor e edukaten shoqerore ne te gjitha nivelet shkollore para-universitare, duke treguar lidhjet mes trafikimit te genieve njezore, shkaqeve qe cojne drejt tij si dhe ceshtjeve te tjera sociale te lidhure me te (si me siper).</p>	<p>MASH, ON dhe OJF-te</p>	<p>Janar 2005</p> <p>Prill 2005</p>	<p>Nxjerrja e udhezimeve te brendshme nga MASH per te vene si perparesi njohurite mbi ceshtjet gjinore, trafikimin dhe dhunen ne familje ne publikimet e specializuara per mesuesit, dhe ne takimet prinder-nxenes-mesues ne te gjitha nivelet shkollore.</p> <p>Organizimi i nje seminari per vleresimin e nevojave, me ndihmen e eksperteve nderkombetare dhe te OJF-ve, per te rishikuar programet mesimore ekzistuese dhe propozuar ndryshimet ku eshte e nevojshme.</p>	<p>Ekzistuese</p> <p>Ekzistuese, te reja e donatoret.</p>
<p>(iii) Rritja e cilesise dhe sasise se informacionit zyrtar e te besueshem te dhene medias mbi arrestimet, ndjekjet penale dhe denimet ne ceshtjet e trafikimit, si nje mjet parandalues ndaj trafikimit dhe trafikuesve (se bashku me trainimin mbi ceshtjet e te drejtave te njeriut per punonjesit e mediave) (Shih Trainimi i Medias, tek NDJEKJA PENALE).</p>	<p>PSH/MRP, MD, ne bashkepunim me PP dhe perfaqesuesit e ON-e, OJF-ve dhe medias.</p>	<p>Maj 2005</p> <p>Janar 2006</p>	<p>Hartimi dhe futja e programeve mesimore te rishikuara, ne vazhde te perfundimeve te nxjerra pas seminarit per vleresimin e nevojave, si dhe me ndihmen dhe keshillat e organizatave nderkombetare dhe OJF-ve.</p> <p>Organizimi i nje seminari per policine, prokurorine dhe mediat, me ndihme nderkombetare, per te krijuar nje marredhenie pune me bashkepunuese, me te orientuar drejt viktimes, dhe me ligjore mes institucioneve te zbatimit te ligjit dhe medias.</p> <p>Raportim me i pershtatshem dhe i ndjeshem nga ana e medias i ceshtjeve te trafikimit, sipas monitorimit te OJF-ve te pavarura ne fushen e medias.</p>	<p>Ekzistuese, e donatoret</p> <p>Donatoret</p>

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (b):** Te zhvillohen nisma me financime publike si dhe nga OJF-te per te organizuar kurse profesionale dhe alternativa te tjera kunder trafikimit dhe ri-trafikimit per grupet ne rrezik.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendese)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Hartimi dhe miratimi i nje pakete nismash qeveritare per nxitjen e alternativave profesionale perkundrejt migrimit te paligjshem, trafikimit e ri-trafikimit te grave te reja, vajzave e femijeve, duke ofruar kredi te vogla, taksa me te ulta, e programe mikro-ekonomike per te mbeshtetur ndermarrjet e vogla e te mesme te reja te cilat kane ne objektivin e tyre femijet te cilet braktisin shkollen si dhe grupet dhe rajonet me rrezikshmeri te larte trafikimi; si dhe duke subvencionuar aktivitetet per krijimin e vendeve te reja te punes e per ri-integrim te zhvilluara nga strehat dhe punedhensit qe bashkepunojne me to. (Paralelisht me Strategjine Kombetare per Uljen e Varferise, Strategjine per Zhvillimin Shoqeror dhe Ekonomik dhe Shpermdarjen e Sherbimit Social, si dhe me institucione huadhense nderkombetare te lidhura me to.)	MPCS, MF, MASH, PSH/MRP, etj.	Mars 2005  Prill 2005  Qershor 2005	Miratimi nga Parlamenti i projektligjit mbi krijimin e bizneseve sociale dhe financimin nga qeveria te asistences me sherbime sociale te OJF-ve.  Miratimi nga Parlamenti i rregulloreve dhe akteve nenligjore per te vene ne zbatim cka u permend me siper, perfshire futjen e perjashtimeve nga taksat te punedhensesve dhe krijimin e sistemeve per hua dhe mikro-kredi per ato biznese te cilat punesojne anetare te grupeve dhe komuniteteve ne rrezik dhe viktime te ri-integuara te trafikimit.  Zhvillimi i nje studimi social per te pare nivelin e cenueshmerise nga trafikimi te grupeve shoqerore te pafavorizuara, dhe per te permiresuar e bere me efikas procesin e shpermdarjes se sherbimeve sociale.	Ekzistuese  Ekzistuese, te reja e donatoret  Ekzistuese, e donatoret
(ii) Nxjtja e punesimit te sigurte e jo-shfrytezues jashte vendit duke bere bisedime per skema emigrimi per punesim me vendet kryesore te destinacionit ne Evrope etj, dhe duke publikuar e monitoruar venien ne zbatim nepermjet zyrave te licensuara per punesim, te marveshjeve per migrim te ligjshem per punesim dhe mundesive te tjera te ligjshme per punesim jashte vendit. (Paralelisht me projekt-Strategjine Kombetare mbi Migrimin).	MPCS	Mars 2005	Fillimi dhe publikimi i Nismes per Punesim te Sigurte; marveshje me zyra te licensuara punesimi ne Shqiperi dhe vendet pritese; rritje e numrit te te rinjve ne gjendje te gjejne vende pune jashte vendit me menyra te sigurta e te ligjshme.	Ekzistuese
(iii) Zbatimi i regjimeve ekzistuese per licensim dhe monitorim per te normuar veprimtarine e agjencive private te punesimit/udhetimit te cilat ofrojne pune jashte vendit, duke bere te mundur qe vetem agjencite e licensuara dhe te cilat veprojne ligjerisht e profesionalisht te lejohe te kene aktivitetin e tyre dhe ta reklamojne ate ne median e shkruar dhe ate elektronike.	MPCS, PSH/MRP	Mars 2005  Mars 2006	Fillimi i nismes per licensimin dhe monitorimin e agjencive te punesimit; udhezime te nxjerra per median ne lidhje me reklammat.  Numerim i agjencive te punesimit, i kryer nga MPCS; rifreskimi dhe berja publike e nje liste te agjencive te miratuara; identifikim dhe bllokim me efikas i agjencive mashtruese.	Ekzistuese  Ekzistuese
(iv) Krijimi i nje zyre kombetare per kontrollin dhe hetimin e praktikave shfrytezuese te punesimit nepermjet Internetit, perfshire nxitjen per trafikim te qenieve njerezore dhe trafikim/pornografi femijesh.	PSH/MRP, ne bashkepunim me MPCS dhe PP	Qershor 2005	Krijimi i zryres per monitorimin e Internetit, trainimi i personelit, dhe venia ne funksionim te plote ne MRP, ne bashkepunim me agjenci te tjera te ngjashme ne vende te tjera.	Ekzistuese, te reja e donatoret.

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (c):** Te rriten mundesite per perfshirje me te gjere shoqerore te grupeve ne rrezik duke zbatuar ligjin per arsimin e detyrueshem dhe regjistrimin ne zyrat e gjendjes civile, dhe duke ofruar arsimim/trainim profesional kompensues per ata qe kane braktisur shkollen (ne perputhje me projekt-Strategjine dhe Planin e Veprimit 2005-7 per Trafikun e Femijeve).

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendese)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te behen perpjekje te perbashketa, perfshire penalizimin e prinderve, per te zbatuar ndjekjen e detyrueshme te shkolles, sidomos per vajzat e reja, si dhe duke ofruar arsimim kompensues, trainim dhe kurse kunder analfabetizmit per grate dhe femijet te cilet e kane braktisur shkollen.	MASH	Mars 2005  Mars 2005	Nxjerrja e udhezimeve mbi arsimin e detyrueshem per inspektorët e shkollave, dhe publikimi i tyre ne media.  Kryerja e nje studimi per te identifikuar zonat me ne nevoje per programe ndertimi shkollash dhe qendrash arsimimi kompensues.	Ekzistuese  Ekzistuese, e donatoret
(ii) Te sigurohet plotesimi I dokumentacionit te duhur ligjor per lindjet, shtetesine dhe martesin si nje ndihme ndaj perfshirjes ne shoqeri dhe mundesise per te perftuar arsimim dhe sherbime te tjera shoqerore, sidomos per grate dhe femijet.	MPVD	Dhjetor 2004  Qershor 2005	Zhvillimi i nje fushate ne media per te publikuar nismen per regjistrimin e te gjithe popullise.  Perfundimi i programit per kompjuterizimin e te gjithe zyrave te gjendjes civile.	Ekzistuese  Ekzistuese

## IV. BASHKERENDIMI

**SYNIME STRATEGJIKE 1:** Te zhvillohet bashkepunimi ndermjet punonjeseve te ministrive dhe institucioneve perkatese, OJF-ve dhe Zyres se Ministrit te Shtetit per Koordinim per te permiresuar frytshmerine e venies ne zbatim te Planit Kombetar te Veprimit per Anti-Trafikun, si dhe per te rritur cilesine e raportimit dhe bashkepunimit nderkombetar te Shqiperise ne fushen e anti-trafikut.

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (a):** Te permiresohet funksionimi i grupit te posacem me Pikat e Kontaktit nga cdo Ministri e institucion i interesuar, i krijuar sipas Planit te Veprimit 2003-2004 per te monitoruar punen ne nivelin nder-institucional ne kohen ndermjet mbledhjeve te Komitetit Drejtues Nder-Ministror per Anti-Trafikun.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Te rishikohet perberja e grupit te posacem me pikat e kontaktit nder-institucionale per te identifikuar punonjesis me te pershtatshem neper ministri e institucione, te afte per permbushjen e kerkesave per monitorim, vleresim dhe raportim nder-institucional te rregullt qe ka Zyra e Ministrit te Shtetit (dhe ministrite e tjera me pergjegjesi kombetare dhe nderkombetare per monitorim e raportim ne fushen e anti-trafikut).	MSH, ne bashkepunim me ministrite dhe institucionet e linjes.	Dhjetor 2004	Rishikimi dhe ripunimi i perberjes se grupit te Pikave te Kontaktit nga ana e Komitetit Drejtues Nder-ministror; krijimi i nje grupi me efikas dhe afatgjate i Pikave te Kontaktit.	Ekzistuese
(ii) Te organizohen takime me te rregullta (te pakten nje here ne muaj) te grupit te posacem te pikave te kontaktit nder-institucionale, te perforcuara sipas nevojese edhe me perfaqesues te Prokurorise se Pergjithshme, per te bere te mundur raportime dhe vleresime me te shpejta e te sakta.	MSH, ne bashkepunim me ministrite dhe institucionet e linjes.	Dhjetor 2004	Komiteti Drejtues Nder-ministror krijon programin per takime mujore te Grupit te Pikave te Kontaktit, duke filluar nga Janari 2005, dhe miraton modalitetet per pjesemarrjen e vezhguesve nga PP.	Ekzistuese
(iii) Tu kerkohet te gjitha ministrive dhe institucioneve qe te kerkojne miratimin e meparshem te Ministrit te Shtetit per Koordinim perpara se te hyjne ne marreveshje bashkepunimi, programe te perbashketa, memorandume mirekuptimi per anti-trafikun, etj, me organizata/institucione nderkombetare apo OJF kombetare e nderkombetare, ne menyre qe te shmanget duplikimi, te sigurohet nje perdorim i kujdesshem i burimeve qeveritare dhe te permiresohet ne pergjithesi njohuria e qeverise per perpjekjet qe zhvillohen ne Shqiperi ne luften anti-trafik.	MSH, ne bashkepunim me ministrite dhe institucionet e linjes.	Dhjetor 2004	Nxjerrja e udhezimeve nga Komiteti Drejtues Nder-ministror, me ane te te cilave kerkohet lajmerim paraprak i Ministrit te Shtetit per Koordinim nga Ministrite e linjes dhe Grupi i Pikave te Kontaktit per angazhimet e propozuara kombetare dhe nderkombetare per bashkepunim; bashkerendim me efikas ndermjet institucioneve qeveritare.	Ekzistuese
(iv) Te organizohet te pakten nje takim ne cdo tre muaj i Grupit Te Posacem Te Pikave Te Kontaktit dhe/ose Komitetit Drejtues Anti-Trafik Nder-Institucional me OJF kombetare e nderkombetare, organizata/institucione nderkombetare dhe donatore te rendesishem, per te diskutuar perparesite anti-trafik te qeverise, ceshtjet e venies ne zbatim si dhe te marrjes se te dhenave; dhe nevojat e qeverise per dhurime/trainime.	MSH, ne bashkepunim me te gjitha ministrite dhe institucionet.	Janar 2005	Takim i perbashket i Komitetit Drejtues Nder-ministror/Grupit te Pikave te Kontaktit, me OJF-te, ON dhe donatoret per te prezantuar Planin e Veprimit 2004-2006, dhe per te diskutuar nevojat per donatore e asistence.	Ekzistuese
		Janar 2005 e ne vazhdim	Hartimi nga Komiteti Drejtues Nder-ministror i programit te takimeve 3-mujore me OJF-te, donatoret, etj.	Ekzistuese

**OBJEKTIVA SPECIFIKE (b):** Te vihen ne zbatim kerkesat e rishikuara per raportimin statistikor te parashikuara ne kete Plan Veprimi, si nje ndihme e rendesishme per vleresimin e veprimtarise sone, dhe per te permbushur detyrimet kryesore nderkombetare per raportim.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
(i) Tu kerkohet Grupit te Posacem me Pikat e Kontaktit te plotesojne Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor ne forme periodike dhe ne tabela, te drejtuara Ministrit te Shtetit per Koordinim, sic pershkruhet tek Objektivat Strategjike e Specifike te ketij Plan Veprimi.	MSH, ne bashkepunim me ministrite dhe institucionet e linjes.	Janar 2005 e ne vazhdim	Komiteti Drejtues Nder-Ministror i Grupin e Pikave te Kontaktit te plotesoje Kerkesat e Rishikuara per Raportim Statistikor ne Planin e Veprimit 2005-2007.	Ekzistuese



**OBJEKTIVA SPECIFIKE (c):** Te permiresohet bashkerendimi i perfaqesimit zyrtar te Shqiperise ne takime nderkombetare dhe rajonale per anti-trafikun, dhe te lehtesohet bashkerendimi i Strategjise Anti-Trafik te Shqiperise me ato te vendeve fqinje dhe te rajonit, si edhe me rekomandimet e organizmave dhe institucioneve nderkombetare.

Aktivitetet	Institucionet Pergjegjese (Te renditura sipas rendesise)	Afati Kohor	Tregues	Burimet
<p>(i) Harmonizim i zbatimit te Planit Kombetar te Veprimit 2005-7 me rekomandimet e Projektit te BE/CARDS: "FORCIMI I STRATEGJIVE PER ZBATIM TE PLANEVE KOMBETARE TE VEPRIMIT ANTI-TRAFIK TE VENDEVE TE PAKTIT TE STABILIZIM-ASOCIMIT"; te caktohet nje grup prej 5 anetaresh te Grupit te Pikave te Kontaktit qe te marrin pjese si Grupi Shqiptar i Zbatimit te Projektit (PIT); dhe te hartohet nje strategji per te vene ne zbatim kerkesat e ketij Plan Veprimi 2005-7 per mobilizimin dhe vleresimin e burimeve, ne perputhje me udhezimet dhe keshillat e QNZHPM-se.</p>	<p>MSH, ministrite, institucionet dhe OJF-te e linjes</p>	<p>Janar 2004  Janar 2005  Mars 2005 e ne vazhdim  Dhjetor 2005  Qershor 2006</p>	<p>Finalizimi i Planit te Veprimit, ne perputhje me udhezimet e QNZHPM-se dhe keshillat e sekretariatit te QNZHPM-se; konfirmimi nga Komiteti Drejtues Nder-ministor i caktimit te grupit shqiptar te zbatimit te projektit.  Raportim tek Ministri i Shtetit per Koordinim i Ministrive te Linjes mbi fondet shtese ne buxhet, te nevojitura per venien ne zbatim te Planit te Veprimit 2004-2006.  Raportim tek Ministri i Shtetit per Koordinim i Ministrive te Linjes ne mbledhjet 3-mujore te Komitetit Drejtues Nder-ministor mbi shpenzimet e bera per venien ne zbatim te cdo aktiviteti.  Raport i fundvitit nga Ministri i Shtetit mbi shpenzimet e bera nga qeveria dhe donatoret per venien ne zbatim te Planit te Veprimit 2005-2007.  Raport nga Ministri i Shtetit, ne bashkepunim me ministrite e linjes, per te vleresuar ndikimin e aktiviteve te Planit te Veprimit, dhe per te bere rekomandime per vleresim te jashtem te ndikimeve.</p>	<p>Ekzistuese  Ekzistuese  Ekzistuese  Ekzistuese  Ekzistuese, e donatoret</p>
<p>(ii) Te sigurohet qe te gjitha ministrite dhe institucionet te informojne me pare Zyren e Ministrit te Shtetit per cdo takim nderkombetar apo rajonal per anti-trafikun ne te cilat ftohen nepunesit e tyre, dhe te qarkullojne raportet e pjesemarrjes tek te gjitha anetaret e Grupit te Posacem te Pikave te Kontaktit/Komitetit Drejtues Nder-ministor.</p>	<p>MSH, ministrite dhe institucionet e linjes</p>	<p>Janar 2005 e ne vazhdim</p>	<p>Leshimi i udhezimeve nga Komiteti Drejtues Nder-ministor per lajmerim paraprak te Ministrit te Shtetit mbi propozime per pjesemarrjen e ministrive te linjes ne konferenca nderkombetare per ceshtje te anti-trafikimit; dergimi i raporteve te mbajtura nga perfaqesuesit e ministrive te linjes ne konferencat nderkombetare per anti-trafikimin tek Ministri i Shtetit per Koordinim, dhe qarkullimi i tyre ne takimet e Grupit te Pikave te Kontaktit/Komitetit Drejtues Nder-ministor; bashkerendim me efikas i institucioneve qeveritare ne lidhje me perfaqesimin nderkombetar.</p>	<p>Ekzistuese</p>
<p>(iii) Te sigurohet perfaqesim i pershtatshem zyrtar/ministor ne te gjitha takimet kryesore rajonale dhe nderkombetare per ceshtjet e anti-trafikimit.</p>	<p>MSH, ministrite dhe institucionet e linjes</p>	<p>Janar 2005 e ne vazhdim  Janar 2005 e ne vazhdim</p>	<p>Leshimi i udhezimeve nga Komiteti Drejtues Nder-ministor, ku i kerkohet Ministrit te Shtetit per Koordinim dhe ministrive te linjes te shperndajne informacionet per konferencat e ardhshme nderkombetare, dhe te bashkerendojne perfaqesimin zyrtar te Shqiperise; arritja e nje perfaqesimi nderkombetar me efikas.  Caktimi nga ana e Ministrit te Shtetit per Koordinim dhe ministrive te linjes e buxheteve me te pershtatshem per perfaqesim ne konferencat nderkombetare per anti-trafikimin.</p>	<p>Ekzistuese  Ekzistuese, e te reja</p>

#### **4. FJALORTH I SHKURTIMEVE TE PERDORURA NE “KUADRIN STRATEGJIK DHE PLANIN KOMBETAR TE VEPRIMIT 2005-2007”:**

**BE – Bashkimi Evropian**

**CAAHT - Programi i Veprimit te Bashkerenduar kunder Trafikimit te Qenieve Njerezore**

**CARDS – Program i Bashkimit Evropian per Ndhime, Rindertim, Zhvillim dhe Stabilizim.**

**IOM-Organizata Nderkombetare per Migrim**

**ICITAP – Programi Nderkombetar i Ndhimes ne Trainimin per Hetimin e Krimeve**

**MRP-Ministria e Rendit Publik**

**MPCS-Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale**

**MASH-Ministria e Arsimit dhe Shkences**

**MSH-Zyra e Ministrit te Shtetit**

**MD-Ministria e Drejtesise**

**MPJ-Ministria e Puneve te Jashtme**

**MF-Ministria e Financave**

**MM – Ministria e Mbrojtjes**

**OJF/OJQ-Organizata jo-fitimpruresse/Organizata jo-qeveritare**

**ON – Organizata Nderkombetare**

**OSBE-Organizata per Sigurine e Bashkepunimin ne Evrope**

**PAMECA – Misioni i Ndhimes Policore te Komunitetit Evropian ne Shqiperi**

**PP-Prokuroria e Pergjithshme**

**PSH-Policia e Shtetit**

**QATV-Qendra Anti-Trafik e Vlores**

**QNZHPM-Qendra Nderkombetare per Zhvillimin e Politikave te Migrimit (ICMPD)**

**SHKB-Sherbimi i Kontrollit te Brendshem (ne MRP)**

**SECI – Nisma Bashkepunuese e Evropes Juglindore**

**TIMS – Sistemi i Menaxhimit Total te Informacionit**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Këshilli i Ministrave**

**V E N D I M**

Nr. 171, datë 11.2.2005

**PËR**

**MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE KUNDËR TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE DHE MBROJTJEN E FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT DHE PER NJË SHITESË NË VKM NR. 8, DATË 05.01.2002 TE KESHILLIT TE MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHETETËROR TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QËNIEVE NJERËZORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit.
2. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Luftës Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore për ndjekjen, kontrollin dhe zbatimin e detyrave të caktuara në këtë strategji.
3. Në pikën 1 të VKM Nr.8, datë 05.01.2002 te Keshillit te Ministrave, shtohet emertimi:

“Zëvendësministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, anëtar”

**Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.**

**MINISTRI I SHETITIT PER KOORDINIMIN**

**MARKO BELLO**

**K R Y E M I N I S T R I**

**FATOS NANO**





**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I MINISTRAVE  
ZYRA E MINISTRIT TE SHTETIT PER KORDINIM**

**STRATEGJIA KOMBETARE  
KUNDER TRAFIKIMIT TE FEMIJEVE  
DHE MBROJTJES SE FEMIJEVE VIKTIMA TE  
TRAFIKIMIT**

**I. Hyrje:**

Gjate dekadës së fundit, Shqipëria ka kaluar një proces të vështirë dhe kompleks tranzicioni, i cili është shoqëruar me papunësi dhe varfëri, të pandëshura me parë, lëvizje demografike të pakontrolluara brenda vendit dhe jashtë tij, dhe me një fenomen të ri, si rezultat i këtyre ndryshimeve.

Fillimisht lëvizjet masive dhe largimet drejt perëndimit u bënë si rezultat i përmbysjes së sistemit politik, nevojës për hapje të kufijve dhe një jete më të mirë. Kështu deri në fillim të vitit 1992 pati largime masive drejt perëndimit, kryesisht drejt Greqisë e Italisë, si dy vendet më të afërta.

Pas viteve 1992, pas këtij emigracioni masiv, elemente kriminale dhe të korruptuar filluan që të krijojnë rrugë trafikimi ilegale, nga ku siguruan fitime të mëdha. Në këto faze filloi dhe aktiviteti kriminal i trafikimit të qenieve njerëzore, duke përfshirë këtu trafikimin e grave dhe femijëve me qëllim shfrytëzimi, një fenomen thellësisht negativ në shoqërinë Shqiptare, duke sjellë fitime mjaft të mëdha për trafikantët.

Përveç konflikteve të zgjatura në Ballkan, mungesës së stabilitetit të brendshëm, krimi i organizuar kombëtar dhe nderkombëtar, rrjetet e trafikut, si dhe lëvizjet e pakontrolluara të kalimit të kufijve, e përkeqësuan fenomenin e trafikut në vend, duke sjellë një fluks të madh migrantësh të paligjshëm, duke përfshirë këtu gra dhe femije nga vendet e Europës Lindore si dhe nga vende të tjera më të largëta, si për qëllime shfrytëzimi në Shqipëri, ashtu edhe duke i tranzituar drejt Europës.

**II. Trafiku i femijëve për qëllim shfrytëzimi dhe fitimi:**

Ndryshe nga më sipër, trafiku i femijëve në Shqipëri, kryesisht në vendet fqinje, është një nga fenomenet më shqetësuese dhe një nga plagët sociale më serioze, duke patur parasysh vulnerabilitetin e femijëve, dhe pasojat në demtime fizike dhe psikologjike në jetën e femijëve, si dhe për brezat e ardhshëm.

Ne Shqipëri, varferia u shoqërua me dobësim të traditës, humbje të lidhjeve familjare dhe solidaritetit të afërmeve (lidhjeve të gjakut). Këto situata rënduan në shoqëri dhe familjen shqiptare dhe vecanërisht mbi fëmijet, të cilët janë dhe pjesë me vullnetshëm në një familje.

Në disa raste, abandonimi i shkollës në zonat rurale, dhe lëvizja masive demografike e familjeve, vecanërisht nga zona veri-lindore, solli që shumë fëmijë të fillojnë të punojnë në rrugët e qyteteve të mëdha, nga ku ata u bënë viktimë të rekrutimit në aktivitete kriminale dhe në rrjetë trafikimi të organizuara. Në raste të tjera, sidomos në komunitete dhe familje të marginalizuara, jo të ndergjegjesuara për trafikimin dhe pasojat e tij, në shumë raste nxiten dërgimin e fëmijëve jashtë shtetit me besimin se atje do të krijojnë një të ardhme më të mirë, duke bërë dhe marrëveshje me të ashtuquajturit “mbrojtës”.

#### **Burimet me të spikatura të rekrutimit të fëmijëve për trafikim janë:**

- Familje të divorcuara ku mungon kujdesi familjar
- Nga familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike
- Nga familje fshatare me shprehje ndihme nga fëmijet
- Nga fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes
- Nga familje që prindërit u janë larguar për punë jashtë shtetit
- Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypsi e veprimtari tjetër të kundershtueshme edhe në Shqipëri
- Fëmijë që nuk mund të shkojnë në shkollë
- Fëmijë të paregjistruar që në lindje
- Familje ku të paktën një fëmijë është trafikuar edhe me parë
- Familje ku fëmijet kanë paaftesi më të mirë nga prindërit me paaftesi më të këqija
- Fëmijë të dale nga martesë e prindërve në moshë të re

Rrugët e trafikimit të fëmijëve zakonisht janë të njëjtat me ato të trafikimit të qenieve njerëzore, por nga trafikantët përdoren edhe dokumente të falsifikuara si kujdestare apo prindërit e tyre. Vendet e destinacionit, ku trafikohen fëmijet, janë zakonisht vendet fqinje, si Italia dhe Greqia, ku rrjetet e trafikut dhe grupet e organizuara kriminale shtrijne veprimtarinë e tyre edhe në vende të tjera të Europës.

Sipas një OJQ ndërkombëtare, numri i fëmijëve të pashoqëruar gjatë kësaj dekade në emigracion llogaritet rreth 4000, kryesisht në vendet fqinje. Ka OJF të tjera që sjellin shifra që fëmijë që janë larguar ilegalisht dhe janë shfrytëzuar për lypsi, punë fizike, dhe aktivitete të tjera të paligjshme arrijnë deri në 6000. Për natyrën klandestine të fenomenit, si dhe mungesën e informacionit nga vendet e destinacionit, konfirmimi i këtyre shifrave është shumë i vështirë megjithatë fenomeni është mjaft shqetësues edhe sikur shifrat realisht të jenë më të ulta.

### **III. Strategjia Kombëtare për Luftën Kundra Trafikut të Qenieve Njerëzore ; 2001-4 ;**

Në Dhjetor 2001, Qeveria Shqiptare, duke e konsideruar luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe të gjithë formave të tij si një prioritet shqiptar dhe ndërkombëtar, aprovoi Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundra Trafikut të Qenieve Njerëzore 2001-4, e hartuar nga strukturat qeveritare në bashkëpunim me OJQ-të lokale dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë në fushën e anti-trafikut.

Strategjia Kombëtare përfshin objektiva dhe specifika në programe afatshkurtra dhe afatmesme në fushat e parandalimit dhe mbrojtjes, ndjekjes penale dhe denimit të trafikantëve (si dhe reformat e duhura ligjore) si dhe fushatat e ndergjegjesimit dhe masat sociale dhe institucionale për strehimin dhe reintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikut.

Megjithatë Trafiku i Fëmijëve nuk është në fokusin kryesor të Strategjisë Kombëtare me 2001,

Strategjia dhe masat e marra ne kete kuader njohin per here te pare dimensionin human, social, ligjor dhe kompleksitetin institucional per luften kunder trafikut te femijeve dhe riintegrimin e tyre, si dhe rendesine e zhvillimit social dhe ekonomik, uljen e varferise dhe dhenien e mundesive te barabarta per te gjitha qytetaret shqiptare per te bere te mundur shfarosjen e ketij fenomeni.

Gjithashtu ne kete Strategji konstatohet se lufta kunder trafikut te qenieve njerezore kerkon nje angazhim jo vetem te institucioneve shtetore, por edhe te organizatave nderkombetare dhe OJQ-ve, qe ofrojne kapaciete dhe eksperience unike ne kete fushe. Nje nga arritjet me te fuqishme te Strategjise eshte dhe institucionalizimi ne nje nivel me te larte te bashkepunimit me OJQ-te dhe organizatat nderkombetare qe operojne ne Shqiperi, si dhe permiresimi i bashkepunimit dhe iniciativave te dyaneshme me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare te vendeve te rajonit.

Si rezultat i rritjes se punes te forcave te rendit dhe zbatimi i detyrave te Strategjise Kombetare nga kordinimi i punes i te gjitha institucioneve si qeveritare ashtu dhe jo-qeveritare ne fushen e ndjekjes penale, mbrojtjes dhe parandalimit, Shqiperia ka bere nje perparim te dukshem ne lufte kunder fenomenit te trafikut duke filluar qysh me 2001, jo vetem ne uljen e numrit te viktimave nga ky trafik ne vend, por gjithashtu me 2002 Shqiperia nuk ka me statusin e nje vendi kryesor destinacioni dhe tranziti (ne krahasim me origjinen).

Megjithate, nga konstatimet e organizmave te brendshem dhe nderkombetar, ne Shqiperi jane identifikuar dobesi ne zbatim, te cilat vazhdojne te kene nje ndikim negativ megjithe perpjekjet e qeverise shqiptare. Ne keto dobesi perfshihet, krahas te tjerave, vazhdimi i emigrimit ilegal te femijeve ne vendet fqinje, kryesisht Greqi dhe Itali, dhe mungesa e strukturave te nevojshme parandaluese dhe mbrojtese si dhe kapacitetet per t'ju kunderpergjigjur problemit ne nje menyre sa ne efektive.

Si rezultat, ne Tetor 2003, qeveria shqiptare aprovoi Planin e Punes Anti-trafik 2003-4, brenda kuadrit te Strategjise Kombetare, ku nje nga objektivat ishte dhe hartimi i Strategjise per Luften Kunder Trafikut te Femijeve. Ne Planin e Punes 2003-4 perfshihej edhe ngritja e nje grupi nder-ministor, brenda strukturave qeveritare per te luftuar trafikun e qenieve njerezore, per te punuar me organizatat kombetare, OJQ-te dhe organizatat nderkombetare, per te hartuar, zbatuar dhe monitoruar objektivat ne kuader te luftes kunder trafikut te femijeve, ne te gjitha aspektet e tij.

#### **IV. Drafti i Strategjise Kombetare dhe Plani i Punes per Luften kunder Trafikut te Femijeve dhe Mbrojtjes se Femijeve, Viktima te Trafikut ; 2004-6**

Kjo Strategji e re nuk dublon Strategjine Kombetare Kunder Trafikut te Qenieve Njerezore, e cila vazhdon te zbatohet, por e shikon fenomenin e trafikimit ne nje kendveshtrimi te ri, brenda kuadrit te Strategjise Kombetare, dhe synon qe te intensifikoje, per kete qellim kordinimin dhe bashkepunimin ndermjet institucioneve dhe organizmave qeveritare, nderkombetare dhe lokale, si dhe te OJQ-ve.

Kjo Strategji u hartua nga nje grup pune me specialiste nga Ministri i Shtetit per Koordinim, Ministria e Rendit, Ministria e Arsimit dhe e Shkences, Ministria e Punes e Çeshtjeve Sociale, Prokuroria e Pergjithshme. Keta specialiste punuan si nje grup pune "ad hoc". Ne punen e tij grupi u mbeshtet nga UNICEF-i, dhe u ndihmua nga BTKF, (Bashke Kunder Trafikimit te Femijeve) nje rrjet shoqatash qe punojne sebashku kunder trafikimit te femijeve, duke perfshire ketu edhe IOM, ILO, ICMC dhe OSCE. Gjithashtu kjo initiative u mbeshtet edhe nga Task Forca e Paktit te Stabilitetit per Europen Jug-Lindore. (TFPC)

Ne hartimin e kesaj Strategjie, grupi i punes u bazua edhe ne Udhezimin e UNICEF 2003 per Mbrojtjen e Femijeve Viktima te Trafikut ne Europen Jug-lindore, u bazua edhe ne instrumentat ligjore vendas dhe nderkombetare, si dhe ne analizat e bera per kete fenomen ne Shqiperi nga OJQ vendase dhe te huaja.

## **V. Objektivat e Strategjise se Luftes Kunder Trafikut te Femijeve dhe Plani i Punes ;**

Strategjia per Luften Kunder Trafikut te Femijeve ka si qellim pershpjtimin e iniciativave te ndermarra per te ulur dhe ndaluar fenomenin e trafikut te femijeve ne Shqiperi, duke intensifikuar dhe kordinuar aktivitetet e te gjitha institucioneve qeveritare, partnereve nderkombetare, OJQ-ve vendase dhe huaja permes permbushjes se objektiveve, detyrave dhe afateve kohore bashkangjitur ne Planin e Punes per nje periudhe 2 vjecare (2004 – 2006)

Ne kete Strategji dhe Plan Pune i eshte vene prioritet identifikimit dhe ndjekjes penale te trafikanteve dhe organizatoreve permes rritjes se perpjekjeve te forcave policore ne vend dhe pergjate kufijve, si dhe masa qe do te merren per femijet, qe jane ne rrezik, ose qe jane trafikuar, per t'i ofruar atyre ndihme mjeksore, psikologjike, sociale dhe ekonomike.

Ne kete kendveshtrim, kjo Strategji e re, nuk parashikon vetem masat per nje strehim te perkohshem dhe ngritjes se kapaciteteve per institucionet dhe punonjesit sociale, por edhe rehabilitim afatgjate dhe integrimin, si ndihme familjare, zhvillimi i sherbimeve te perkujdesjes dhe adoptimit, te bazuar ne te drejten qe cdo femije ka per t'u rritur ne familje.

Gjithashtu jane parashikuar masa ne lidhje me abandonimin e shkolles, punes se paligjshme per femijet, uljen e varferise dhe nevojat per trajnime profesionale, si alternativa per te ulur emigracionin e paligjshem, trafikimin dhe ri-trafikimin.

Nje prioritet i eshte dhene dhe masave ne kuader te ndergjegjesimit te publikut, si nga qeveria dhe organizatat kombetare dhe nderkombetare te specializuara, duke vene theksin ne zonat rurale, dhe ne sektoret me ne nevojte te shoqerise urbane.

Kjo Strategji gjithashtu parashikon krijimin e nje strukture te vecante ne nivel prefektore per te kordinuar dhe monitoruar parandalimin e trafikut te femijeve, mbrojtjen dhe rehabilitimin, arsimimin, sherbimin shendetesor dhe social, punen policore dhe punonjesit e pushtetit lokal. Ne kete Strategji gjithashtu inkurajohet edhe ngritja e partneritetit ne nivel lokal te strukturat qeveritare dhe jo-qeveritare me partneret lokale per te zbatuar objektivat e parashikuara ne planin e punes.

Strategjia bazohet ne parimin dhe bindjen qe ka qeveria shqiptare se trafiku i femijeve, si te gjitha format e tjera te trafikut te qenieve njerezore, perben krim dhe demton dinjitetin dhe te drejtat e njeriut dhe te qytetareve, dhe eshte pergjegjesia kryesore e qeverise per ta luftuar dhe zhdukur kete fenomen.

Ne te njejten kohe theksohet se edhe pse Qeveria Shqiptare ka dhe pranon pergjegjesine kryesore per kete fenomen, ashtu sic manifestohet edhe ne pergjegjesite qe ajo ka marre ne draft Planin e Punes te Strategjise se Luftes Kunder Trafikut te Femijeve, perseri eshte mjaft i nevojshem dhe dobiprures partneriteti dhe bashkepunimi me sektorin jo-qeveritar, me partneret dhe donatoret nderkombetare, duke marre parasysh ketu dhe mungesen e burimeve financiare dhe njerezore, si dhe duke vleresuar ekspertizen qe keto organozata ofrojne ne fusha specifike.

## **VI. Struktura e Planit te Punes te Luftes Kunder Trafikut te Femijeve ;**

**Ne perputhje me sa me siper, Plani i Punes eshte hartuar sipas nje strukture me pese pika, qe eshte rene dakort me partneret vendas dhe nderkombetare:**

- Parandalimi (ku perfshihet forcimi i ligjit dhe rritja e kontrollit te kufijve, rritja e ndergjegjesimit, edukimi dhe informimi, si dhe trajnime ne nivel lokal dhe kombetar, duke u fokusuar ne komunitetet me vulnerabel);
- Mbrojtja dhe Riintegrimi i Femijeve, Viktima te Trafikut (ku perfshihet kuadri ligjor, forcat policore, ndjekja penale dhe procedurat ligjore);
- Kthimi vullnetar i asistuar ( bazohet mbi praktikat me te mira per identifikimin, mbrojtjen, dhe kthimin ne vendin e origjines te femijeve);
- Koordinimi i Aktoreve (kombetar dhe nderkombetar, qeveritar dhe jo-qeveritar, ne nivel qendror dhe lokal).

## **VII. Principet e Pergjithshme ku Strategjia e Kunder Trafikut te Femijeve bazohet :**

- **Te drejtat e femijes**

Te gjitha veprimet e ndermarra ne lidhje me femijet viktime do te udheheqen dhe do te jene te bazuara ne parimet e mbrojtjes dhe respektimit te te drejtave te njeriut s'ic eshte parapare ne Konventen e Kombeve te Bashkuara mbi te Drejtat e Femijes (1989).

Femijeve viktime u jepet e drejta te kerkojne masa speciale per mbrojtje, si viktime dhe si femije, ne pajtuesmeri me te drejtat dhe nevojat e tyre speciale.

Perfshirja e femijes viktime ne aktivitetet kriminale nuk duhet te prishe statusin e tyre si femije dhe si viktime.

- **Interesi me i larte i femijes**

Ne te gjitha veprimet qe kane te bejne me femijet viktime, qofshin ato te ndermarra nga institucionet e perkujdesjes sociale publike apo private, nga gjykatat, autoritetet administrative ose nga personat juridike, ne cdo rast detyre paresore duhet te jete interesi me i larte i femijes.

- **E Drejta ne Jodiskriminim**

Femijeve viktime u jepet e drejta te kerkojne masa mbrojtese dhe te drejta te njejta si femijet te cilet jane banore te atij shteti. Para se gjithash ata duhet te konsiderohen si femije. Te gjitha elementet rreth statusit te tyre, perkatesise nacionale, races, gjinise, gjuhes, religjionit, perkatesise etnike ose origjines sociale, lindjes ose ndonje statusi tjetër duhet te jene sekondare.

- **Respektimi i Pikepamjeve te Femijes**

Femija viktime, e cila eshte ne gjendje te formoje pikepamjet e tij apo te saj, gezon te drejten t'i shprehe keto pikepamje ne menyre te qarte lidhur me cdo gje qe ka te beje me te, si ne vendimin e tij apo te saj lidhur me mundesine e kthimit ne familje ose ne vendin e origjines se tij apo te saj.

Pikepamjeve te femijes duhet t'u jepet vemendja e duhur ne pajtuesmeri me moshen e saj apo te tij, ne interesin me te mire te saj apo te tij si dhe me pjekurine e tij apo te saj.

- **E drejta per informim**

Femijeve viktime duhet t'u sigurohen informacion mbi statusin e tyre, situaten e tyre, te drejtat e tyre, sherbimet te cilat i kane ne dispozicion dhe ribashkimin e familjes dhe/ose procesin e riatdhesimit.

Informacioni duhet te sigurohet ne gjuhen ne te cilen femija viktime dhe eshte ne gjendje ta kuptoje. Cdo here duhet te jene ne dispozicion pekthyes te pershtatshem, punonjes sociale apo psikologe, kur femijet viktime merren ne pyetje, kur intervistohen ose ne ato raste kur kerkojne t'u ofrohen sherbime.

- **E drejta ne konfidencialitet**

Informacioni mbi femijen viktime qe mund ta rrezikojne femijen ose ndonje anetar te familjes se femijes, nuk duhen te behen te ditura.

Duhet te ndermerren te gjitha masat e nevojshme per te mbrojtur identitetin dhe intimitetin e femijes viktime. Emri, adresa ose ndonje informate tjetër, e cila mund te çojë drejt identifikimit te femijes viktime ose te anetareve te familjes se femijes nuk duhen t'u behen te njohura mediave apo opinionit te gjere.

Autorizimi i femijes viktime duhet te kerkohet ne perputhje me moshen para se informacioni delikat te behen i njohura.

- **E drejta per te qene i mbrojtur**

Shteti ka per detyre qe t'i mbroje dhe ndihmoje femijet viktime dhe t'u garantoje atyre sigurine.



Te gjitha vendimet lidhur me femijet viktime duhen te ndermerren ne menyre ekspeditive.

## **VIII. Baza Ligjore ku Mbeshtetet Strategjia e Trafikut Kunder Femijeve :**

### **Per qellim te Strategjise dhe Planit te Punes :**

- Trafikimi i femijes eshte akti i rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes ose mbajtjes se femijes, per qellime shfrytezimi si brenda shtetit, ashtu edhe jashte tij.<sup>1</sup>
- Shfrytezimi perfshin shfrytezimin per prostitucion ose forma te tjera te shfrytezimit seksual, punen apo sherbime te tjera te detyruara, skllaverine ose praktikate e ngjashme me skllaverine, heqjen e organeve ose servitudet
- Pajtimi i femijes viktime ne shfrytezimin e paramenduar eshte irelevant edhe nese nuk eshte perdorur njera nga format e poshteshenuara si “dhuna, ndonje forme tjetere e detyrimit, e rrembimit, e mashtrimit, e perdorimit te forces ose veprimeve te ndermarra derisa njeri eshte ne gjendje te ndjeshme ose derisa njeri eshte nen kontrollin e personit tjetere”.
- Femije viktime e trafikimit konsideroheet cilido person nen moshen 18 vjeçare.
- Femije te pashoqeruar ne emigracion konsiderohen femijet qe ndodhen ne emigracion te pashoqeruar nga familjet e tyre. Si te tille ata mund te jene me shume te rrezikuar per t’u trafikuar.

Bazuar ne Strategjine Kombetare te Luftes Kunder Trafikut te Qenieve Njerezore, dhe Konventave perkatese te OKB, si dhe instrumentave te tjere nderkombetare te nenshkruara dhe ratifikuara nga Shqiperia, u be nje rishikim i legjislacionit me 2001, me qellim rritjen e denimit per forma te caktuara te trafikut te qenieve njerezore, si dhe bazuar ne pervojen nderkombetare te dallimit te viktimes nga trafikanti, ku viktime e rritur apo femije trajtohet si viktime dhe nuk ndiqet penalisht.

Ne Ligjin “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Kodin Penal” me 24 Janar 2001, u bene disa ndryshime mbi vepren penale dhe denimet ne rastin e trafikut te qenieve njerezore, trafikut te femrave per prostitucion, si dhe te trafikut te femijeve per qellime shfrytezimi.

Ne te gjitha rastet, denimi eshte me i madh kur viktime eshte i mitur, kur shfrytezimi eshte bere nga nje grup njerezish, per qellime fitimi, apo kur eshte perdorur forca, ose kur vepra eshte kryer ne menyre te vazhdueshme apo ne bashkepunim me te tjeret, permes abuzimit te detyrave shteterore, apo nga organizata kriminale te armatosura.

Kodi penal shqiptar parashikon sanksione per vepra penale qe lidhen ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me trafikimin e njerezve, femrave dhe femijeve. Ketu perfshihen vepra penale te permendura me lart si ndihme per kalim te paligjshem te kufirit, shfrytezimi, financimi dhe dhenia me qera e lokaleve per prostitucion, rrembimin e personit si dhe te femijes, rrezikim i jetes se personit duke e shoqeruar me vuajtje te renda fizike ose psikologjike, rrahje, marredhenie seksuale me dhune, vjedhjen e dokumenteve te identifikimit, falsifikimin e dokumenteve te identifikimit si pasaporta, viza etj.

Me 12 Shkurt 2004, Parlamenti Shqiptar aprovoi me propozim te Keshillit te Ministrave, ligjin nr.9188 ku behen ndryshime dhe shtesa te metejshe te Kodit Penal ne te gjitha fushat e permendura me siper, duke perfshire dhe trafikun e femijeve. Ky ligj i ri paraqet nje perkufizim te ri per veprat penale te trafikimit, sipas Protokollit te Palermos, ku parashikohen denime me te renda si dhe gjoha per autoret e trafikut si dhe per kalimin e paligjshem te kufirit, si dhe rritet denimi me nje te katerten per ata individe qe ushtrojne funksione shteterore.

Detajet e legjislacionit te ndryshuar jane paraqitur ne Tabelen e meposhtme:

---

<sup>1</sup> Protokollit “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave e fëmijëve”, nenshkruar në Palermo, Dhjetor 2001



<b>Neni</b>	<b>Vepra Penale</b>	<b>Sanksioni</b>
<b>110/1</b>	<p>Rekrutimi, transporti dhe mbajtja e personave permes kercenimit ose forces, apo nepermjet formave te tjera te presionit, ose dhenia apo marrja e pageses apo perfitimeve te tjera nga nje person, I cili kontrollon nje tjetër, per qellime shfrytezimi per prostitucion, apo forma te tjera shfrytezimi seksual, pune apo sherbime te tjera te detyruara, per qellime te transplantit te organeve apo te formave te tjera te shfrytezimit.</p> <p>Organizimi, manaxhimi dhe financimi I trafikut te qenieve njerezore</p> <p>Ne bashkepunim me te tjere, ose me shume se nje here, ose kur shoqerohet me keqtrajtime duke e detyruar viktimen te veproje permes perdorimit te dhunes fizike apo psikologjike, ose kur shkakton demtime te renda te shendetit.</p> <p>Kur shkakton vdekjen e viktimes se trafikut</p> <p>Abuzim te funksioneve shteterore ose publike</p>	<p>5-15 vjet burgim dhe gjobe prej 2-5 milion lek.</p> <p>7-15 vjet burg dhe gjobe nga 4-6 milion lek.</p> <p>Jo me pak se 15 vjet burgim dhe gjobe 6-8 milion lek</p> <p>Burg te perjetshem</p> <p>Nje e katert shtese e burgimit dhe gjobes</p>
<b>114/a</b>	<p>Shfrytezimi ne rrethana renduese, perfshirja e te miturve, shtytja, shtrengimi per t'u marre me prostitucion jashte shtetit, kryerja ne bashkepunim ose me shume se nje here, ose e personave te ngarkuar me funksione shteterore e publike.</p>	<p>7-15 vjet burgim</p>

<p><b>114/b</b></p>	<p>Rekrutimi, transporti, mbajtja e femres permes kercenimit ose forces, apo nepermjet formave te tjera te presionit, ose dhenia apo marrja e pageses apo perfitimeve te tjera nga nje person, I cili kontrollon nje tjetër, per qellime shfrytezimi per prostitucion, apo forma te tjera shfrytezimi seksual, pune apo sherbime te tjera te detyruara, per qellime te transplantit te organeve apo te formave te tjera te shfrytezimit.</p> <p>Organizimi, manaxhimi dhe financimi i trafikut te femrave</p> <p>Kur kjo veper kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here ose shoqerohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhune fizike ose psikike te te demtuars per te kryer veprime te ndryshme ose sjell pasoja te renda per shendetin e saj</p> <p>Ka sjelle si pasoje vdekjen e personit te trafikuar</p> <p>Abuzim te funksioneve shteterore ose publike</p>	<p>7-15 vjet burg dhe gjobe nga 3-5 milion lek</p> <p>Burgim 10-15 vjet dhe gjobe nga 5-7 milion lek</p> <p>Jo me pak se 15 vjet burg dhe gjobe nga 6-8 milion lek</p> <p>Jo me pak se 20 vjet burg</p> <p>Nje e katert shtese e burgimit dhe gjobes</p>
<p><b>128/b</b></p>	<p>Rekrutimi, transporti, strehimi ose marrja e femijes, per qellime shfrytezimi per prostitucion apo forma te tjera te shfrytezimit seksual, pune apo sherbime te detyruara, forma skllaveruese apo te tjera te ngjashme me te, transplatimi i organeve, si dhe cdo forme tjetër shfrytezimi.</p> <p>Organizimi, manaxhimi dhe financimi i trafikut te femijeve</p> <p>Ne bashkepunim, ose me shume se nje here, ose shoqerohet me keqtrajtimin ose detyrimin me dhune fizike ose psikike te te demtuarit si dhe kur ka sjelle pasoja te renda per shendetin e femijes se trafikuar.</p> <p>Ka sjelle si pasoje vdekjen e femijes</p> <p>Abuzim te funksioneve shteterore ose publike</p>	<p>7-15 vjet burg dhe gjobe nga 4-6 milion lek</p> <p>10-20 vjet burg dhe gjobe nga 6-8 milion lek</p> <p>Jo me pak se 15 vjet burg dhe gjobe nga 6-8 milion lek</p> <p>Jo me pak se 20 vjet burg dhe gjobe nga 8-10 milion lek</p> <p>Nje e katert shtese e burgimit dhe gjobes</p>

<b>297</b>	Kalimi i paligjshem i kufirit shteteror	Gjobe ose burgim gjer ne 2 vjet.
<b>298</b>	<p>Dhenia e ndihmes per kalimin e paligjshem te kufirit nepermjet venies ne dispozicion ose perdorimi i mjeteve te lundrimit, te fluturimit apo i mjeteve te tjera per te ndihmuar kalimin e paligjshem te kufirit</p> <p>Dhenia e ndihmes per kalimin e paligjshem te kufirit me qellim fitimi.</p> <p>Ne bashkepunim, ose me shume se nje here duke shkaktuar demtime serioze</p> <p>Kur shkakton vdekjen</p> <p>Abuzim te funksioneve shteterore ose publike</p>	<p>1-4 vjet burg dhe gjobe 3-6 milion lek</p> <p>3- 7 vjet burgim dhe gjobe 3-6 milion lek</p> <p>5-10 vjet burgim dhe gjobe 6-8 million lek</p> <p>Jo me pak se 15 vjet burg dhe gjobe 8-10 million lek</p> <p>Nje e katert shtese e burgimit dhe gjobes</p>
<b>109</b>	<p>Rrembimi ose mbajtja peng e personit me qellim per te fituar pasuri ose çdo lloj perfitimi tjeter, per te pergatitur krijimin e kushteve per kryerjen e nje krimi, per te ndihmuar autoret ose bashkepunetoret ne largimin nga vendi i ngjarjes, per t`iu shmangur denimit, per te detyruar realizimin e kerkesave a kushteve te caktuara per qellime politike ose çdo qellim tjeter.</p> <p>Rrembimi ose mbajtja peng e femijet nen 14 vjeç.</p> <p>Rrembimi ose mbajtja peng e personit ose e femijet nen 14 vjeç i paraprire ose i shoqeruar me tortura fizike ose psikike, kur eshte kryer kunder disa personave ose me shume se nje here.</p> <p>Kur eshte shkaktuar vdekja e personit</p>	<p>10-20 vjet burgim</p> <p>Jo me pak se 15 vjet burgim .</p> <p>Jo me pak se 20 vjet burgim .</p> <p>Burgim te perjetshem</p>

## **IX. Monitorimi Strategjise se Trafikut te Femijeve dhe Planit te Punes;**

Pergjegjesine per kontrollin e zbatimit te Strategjise Kombetare dhe Planit te Punes Kunder Trafikut te Femijeve dhe Mbrojtes se Femijeve Viktima te Trafikut, do ta kete Komiteti Shteteror i Luftes kunder Trafikut te Qenieve Njerezore, i drejtuar nga Ministri i Shtetit per Koordinimin.

Grupi i Punes per Luften kunder Trafikut te Femijeve dhe cdo Ministri apo Institucion qe ka detyrime sipas kesaj strategjie te informoje per ecurine e puneve te zbatimit te strategjise Ministrin e Shtetit dhe Komitetin e Luftes kunder Trafikut te Qenieve Njerezore cdo tre muaj nga data e miratimit te Strategjise dhe Planit te Punes ne Keshillin e Ministrave.

Kryeministri do te informohet priodikisht per zbatimin e detyrave te Strategjise dhe Planit te Punes.

## **X. Treguesi shkurtimeve te perdorura ne Strategjine Kombetare dhe Planin e Veprimit per Luften kunder Trafikimit te Femijeve dhe Mbrojtjes se Femijeve, Viktima te Trafikut :**

<b>MRP</b>	<b>Ministria e Rendit Publik</b>
<b>MPCS</b>	<b>Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale</b>
<b>MASH</b>	<b>Ministria e Arsimit dhe Shkences</b>
<b>MSH</b>	<b>Zyra e Ministrit te Shtetit per Koordinim</b>
<b>MD</b>	<b>Ministria e Drejtesise</b>
<b>MPJ</b>	<b>Ministria e Puneve te Jashtme</b>
<b>MPVD</b>	<b>Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit</b>
<b>PP</b>	<b>Prokuroria e Pergjitheshme</b>
<b>DPPSH</b>	<b>Drejtoria e Pergjitheshme e Policise se Shtetit</b>
<b>ICITAP</b>	<b>Programi Nderkombetar i Ndhimes ne Trainimin per Hetimin e Krimeve</b>
<b>OJF</b>	<b>Organizata jo-fitimpruese</b>

# PLANI I VEPRIMIT

## PER LUFTEN KUNDER TRAFIKIMIT TE FEMIJEVE DHE MBROJTJES SE FEMIJEVE, VIKTIMA TE TRAFIKUT

### 1 Parandalimi

- Te vleresohet aftesia e masave aktuale per kontrollin e kufijve ne lidhje me femijet e shoqeruar apo te pashoqeruar, dhe te permiresohet nepermjet trajnimit apo masave te tjera, kapaciteti i policise kufitare per te zbuluar dhe ndaluar trafikimin e femijeve dhe trafikantet si dhe per te ofruar mbrojtje fillestare per femijet e trafikuar.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Te behet trainimi i personelit te policise kufitare per identifikimin dhe parandalimin e rasteve te trafikimit te femijeve si dhe per njohjen e tyre me konventat nderkombetare te nenshkruara dhe ratifikuara nga Republika e Shqiperise per trafikun e femijeve;	MRP, DPPSH (me program te veçante) Ne bashkepunim me organizata nderkombetare dhe OJF-te	Deri ne dhjetor 2005
Te merren masat per rregjistrimin ne nje data baze te veçante per te gjithë femijet qe hyjne dhe dalin nga vendkalimet kufitare te shoqeruar ose te pashoqeruar nga prinderit;	MRP, DPPSH	Deri ne Dhjetor 2005

- Te sigurohet bashkepunimi formal dhe ad-hok nderkufitar me vendet fqinje dhe agjensite e tjera te zbatimit te ligjit ne keto vende si dhe ndermjet strukturave kombetare per mbrojtjen e femijeve, Organizatave Nderkombetare dhe OJQ-te.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Te rishikohen marreveshjet bilaterale te bashkepunimit ndermjet Shqiperise dhe vendeve te rajonit, duke u fokusuar ne problemet e parandalimit te trafikimit te femijeve;	MRP, DPPSH , MPJ	deri ne Dhjetor 2005
Te lidhen marreveshje te reja atje ku nuk ekzistojne, veçanerisht me vendet fqinje lidhur me parashikimin e bashkepunimit ne drejtim te identifikimit te femijeve te trafikuar dhe qe shfrytezohen, per identifikimin e trafikanteve, mbledhjen dhe shkembimin sistematik te informacionit mbi trafikimin e femijeve, metodat dhe rruget e perdorura, dhe koordinimin e masave ndaj fenomenit, duke perfshire edhe procedura te rregulluara per riatdhesimin ne kufi;	MRP, DPPSH , MPJ	deri ne qershor 2006
Te forcohet bashkepunimi ad hoc kufitar vecanerisht me vendet fqinje per shkembimin e informacionit per trafikun e femijeve dhe parandalimin e tij;	MRP, DPPSH	deri ne shtator 2005
Te organizohen seminare, dhe vizita pune per te shkëmbyer eksperiencen ndermjet forcave policore te vendeve te tjera, te perfshira ne lufte kunder trafikut te femijeve	MRP, DPPSH, MPCS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizatat Nderkombetare	deri me Dhjetor 2005
Te sigurohet vendosja e kontakteve me strukturat analoge per mbrojtjen e femijeve shqiptare te trafikuar ne vendet e destinacionit, veçanerisht atje ku ka kontigjente te konsiderueshme, duke bashkepunuar me strukturat shteterore homologe, OJF-te shqiptare, te vendeve te destinacionit dhe organizatat nderkombetare;	MRP, DPPSH , MPCS,MPJ Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005

- Hartimi i nje programi masash ne bashkepunim me median, strukturat qeveritare dhe joqeveritare per ndergjegjesimin e publikut.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Ndergjegjesimi i publikut per rreziqet dhe denimet qe shoqerojne kete forme specifike te trafikimit nepermjet: perfshirjes te problemeve te trafikut te femijeve dhe pasojave te tij, ne kurrikulat mesimore; nxitjen dhe stimulimin e veprimtarise letraro-artistike qe ka ne qender problemet e trafikut te femijeve, spoteve dhe emisioneve televizive, posterave, flete-palosjeve etj, organizimi i kesaj fushate duke u fokusuar ne komunitetet me vulnerabel;	MSH, MPCS, MASH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne shtator 2005
Shperndarje informacioni dhe trainime per zyrtare te policise antitrafik, policise kufitare, doganave, personelit arsimor, sherbimeve sociale etj.;	MRP, DPPSH, MPÇS, PP, DPDoganave, MASH Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Dhjetor 2005
Vazhdimi i zbatimit te programit te perbashket te MASH me IOM per trajnimin e mesuesve mbi trafikun e femijeve dhe pasojave te tij;	MASH, MSH	ne vazhdimesi

- Instruktimi dhe trainimi ne nivel lokal i personelit te policise, arsimit, punonjesve sociale, prokurorise dhe OJF-ve te specializuara:

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Te zhvillohen seminare me kete pjesemarrje lidhur me identifikimin dhe raportimin mbi femijet e humbur apo ne rrezik trafikimi, si dhe te vleresohen femijet ne rrezik (dhe familjet e tyre) dhe te raportohen keto raste;	MRP, DPPSH, MPCS, MASH, MSH, PP Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005
Te ngrihen grupe pune ne njesite qendrore (Prefektura) te pushtetit vendor me pjesemarrje te punonjesve te ketyre njesive (administratore sociale dhe punonjes se gjendjes civile) arsimit, rendit, prokurorise, organizata jo-qeveritare dhe te hartohen programe per ndergjegjesimin e komunitetit dhe masat parandaluese per femijet ne rrezik trafikimi.	MRP, MPVD, MASH, MSH	deri ne Dhjetor 2005

- Te ndermerren masa te mire-koordinuara zyrtare per te hetuar dhe parandaluar rastet e zhdukjes se femijeve, dhe te hartohen procedurat per ri-integrimin arsimor per femijet dhe/ose kurse trajnimi profesionale per femijet qe nuk ndjekin shkollen dhe jane ne rrezik trafikimi.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Rritja e ndergjegjesimit per arsimimin e detyruar dhe forcimin e masave ndeshkuese per prinderit qe nuk mundesojne dergimin e femijeve ne shkolle;	MASH dhe MPVNe bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	ne vazhdimesi
Institucionet arsimore lokale te bejne identifikimin e femijeve qe nuk frekuentojne arsimin e detyrueshem dhe te ngrene ne nivel Prefekture strukturat e nevojshme administrative dhe ligjore per zbatimin e ligjit;	MASH dhe MPV	deri Shtator 2005
Te organizohen aktivite te veçanta arsimimi/edukimi per femijet me prinder te divorcuar ose me nje prind dhe me probleme ekonomiko-sociale ne familje;	MASH ,MPV Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Nentor 2005
Krijimi i nje strukture brenda Prokurorise per femijet, hetimin e rasteve te femijeve te zhdukur, duke bashkepunuar me MASH, MPCs dhe MRP;	PP, MASH, MPCs, MRP Ne bashkepunim me Prganizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Shtator 2005
Te organizohen aktivite edukative per femijet me prinder te divorcuar ose femije me nje prind, ku familjet perballen me probleme socialo-ekonomike;	MASH, MPV Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Dhjetor 2005
Shtrirja e klasave te integruara me programe te veçanta te arsimit baze dhe terheqja ne to e femijeve qe e kane braktisur shkollen ose nuk e kane ndjekur ate, veçanerisht femijet e komuniteteve si romet dhe jevgjit, si dhe kategorine e femijeve te rruges;	MASH,MPV Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Marrja e masave per te inkurajuar terheqjen e vajzave ne arsimin e mesem, veçanerisht ne zonat rurale;	MASH, MPV, M.SH	2005 e ne vazhdim
Te ofrohen kurse profesionale per adoloshentet, te cilet jetojne ne kushte te veshtira ekonomike, sidomos per jetimet dhe vajzat qe kane braktisur shkollen, sipas modelit te qendrave te formimit profesional te ngritura ne Tirane, Fier dhe Elbasan;	MASH, MPV, MPCs Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005
Te krijohet nje sistem informacioni per punesimin, i cili do te ndihmoje ne publikimin dhe shperndarjen e materialeve informuese, formate projektesh, pervojash si dhe informacione per burimet financiare dhe teknike per nxitjen e punesimit te adoloshenteve, ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF;	MPV, MPCs Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Te nxiten Organizatat Nderkombetare dhe OJF per financimin e projekteve me synim ngritjen e aktiviteve prodhuese familjare, shembull i projekteve te mbeshtetura nga Sherbimi Social Nderkombetar – mbeshtetur ne Shqiper nga ai Italian;	MPV, MPCs Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005
Te ngrihet niveli i ekonomik i familjeve te grupeve te marginalizuara, veçanerisht komunitetit rome, permes perfshirjes ne programet e nxitjes se punesimit, mbeshtetjes me baze materiale, mjedise, mjete financiare dhe burime njerezore per zhvillimin e atyre bizneseve qe kane si destinacion produktet e tradites se artizanatit;	MPCs, MASH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	2005 e ne vazhdim
Te nxitet dhe te ndihmohet ngritja e qendrave ditore dhe sherbimet komunitare per integrimin e femijeve rome ne procesin e edukimit dhe ne parandalimin e rrezikut te trafikimit;	MPCs, MASH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	2005 e ne vazhdim
Te ushtrohet kontroll sistematik nga Inspektoriati Shteteror i Punes per punen e zeze te femijeve ne pergjithesi dhe te femijeve rome ne veçanti dhe te merren masat e nevojshme per parandalimin e saj;	MPCs, MASH	2005 e ne vazhdim
Permiresimi i kushteve te institucioneve publike dhe jopublike te perkujdesjes per femije, rritja e kerkeses per mire-rritjen dhe pergatitjen e femijeve per integrimin e tyre ne jete. Pasqyrimi i kerkesave te reja ne rregulloret e funksionimit te ketyre institucioneve;	MPCs, MASH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Pergatitja e nje udhezimi metodologjik dhe organizimi i trajnimeve per ekipin multi-disiplinor te angazhuar ne pergatitjen e integritit social dhe profesional te femijeve te perfshire ne sistemin e institucioneve te perkujdesit per femijet;	MPCs Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Qershor 2005



## 2. Mbrojtja e viktimave

• Te garantohet akomodimi ne qendrat pritese, strehezat (shelter) per referimin fillestar te femije viktima te trafikimit si dhe ata ate ndaluar gjate trafikimit, per t'i pergatitur per rikthim ne familje ose ne mjedise te tjera alternative mbrojtese, per rastet kur kthimi prane familjeve nuk eshte i keshillueshem apo i mundshem:

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Hartimi i rregullores per zbatimin e procedurave te pritjes, transferimit te femijeve, viktima te trafikut nga pikat e kalimit kufitar, ne rastin e arrestimit apo kthimit;	MPÇS, MRP Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Qershor 2005
Te ngrihen ambjente te vecanta me infrastrukturen e nevojshme ne pikat e kalimit te kufirit, per pritjen dhe strehimin e femijeve te trafikuar, para se ata te mberrijne ne familje, apo qendrat pritese;	MRP, DPPSH, MPÇS Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Shtator 2005
Te vendosen standartet per procedurat fillestare te perkudesjes ndaj femijeve, viktima te trafikut, te cilat duhet te zbatohen si nga sektori publik ashtu dhe nga institucionet private te perkujdesjes se femijes, strukturat e tjera per mbrojtjen e femijeve, autoritetet ne fushen e drejtesise, e gjitha kjo bazuar ne interesin me te mire te femijes;	MPCS, MSH, PP Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Qershor 2005
Te permiresohet kapaciteti i Qendres Kombetare Pritese per pritjen dhe strehimin e femijeve, viktima te trafikut;	MPCS Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Qershor 2005
Krijimi i ekipeve te specializuara dhe ambjenteve te vecanta per grup mosha te ndryshme, brenda Qendres Kombetare Pritese per Viktimat e Trafikut;	MPÇS	deri ne Shtator 2005
Rritja e nivelit profesional te stafit te punonjesve sociale pergjegjes per trajtimin e femijeve, viktima te trafikut, nepermjet programeve te formimit profesional dhe trainimeve per problemet e pritjes dhe intervistimit te femijeve viktima te trafikut, te trajtimit psiko-social te viktimave, per rolin e kujdestarise etj;	MPÇS. Në bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Qershor 2005
Te hartohen rregulloret per unifikimin dhe zbatimin e procedurave fillestare te pritjes, intervistimit, ruajtjes se informacionit ne lidhje me femijet, viktima te trafikut, ne perputhje me programin per mbrojtjen e deshmimtareve dhe rolit multi-funksional te Qendres Kombetare Pritese per Viktimat e Trafikut;	MPCS, MRP,PP Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Qershor 2005
Te negociohen dhe nenshkruhen marreveshjet e nevojshme te bashkepunimit ndermjet strukturave pergjegjese shtetore per mbrojtjen e femijeve, duke perfshire dhe Qendren Kombetare Pritese per Viktimat e Trafikut, organizatat nderkombetare, OJF-te (ku perfshihen Qendra "Vatra, Terre des Hommes, UNICEF-i, IOM, ILO, dhe anetaret e tjere te BKTF (Bashke Kunder Trafikut te Femijeve), per zbatimin e nje procesi te unifikuar per pritjen, mbrojtjen dhe procedurat e riintegrimit per femijet, viktima te trafikut;	Kryejne MPÇS, MRP, PP, M.SH Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne qershor 2005
Te hartohen programe integrimi dhe ri-integrimi nga qendrat e pritjes per femijet qe do te qendrojne per nje kohe te gjate ne to;	MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Qershor 2005
Te nxitet dhe te mbeshtetet sherbimi i perhershem apo i perkohshem i kujdestarise per femijet qe kthehen nga trafikimi ose jane ne rrezik trafikimi, kur prinderit kane humbur zotesine prinderore, perkohesisht ose pergjithmone;	MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	qershor 2005 e ne vazhdimesi
Te nxitet, te mbeshtetet dhe te standardizohet sherbimi i kujdestarise duke shfrytëzuar modelet e krijuara nga ofrimi i ketij sherbimi te ri nga disa OJF;	MPÇS. Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Te bashkepunohet me OJF-te e specializuara qe ofrojne sherbimet e kujdestarise, nepermjet nenshkrimit te marreveshjeve te bashkepunimit dhe kontratave;	MPÇS, MSH	deri ne Shtator 2005
Te merren te gjitha masat e nevojshme per te mbrojtur sigurine e femijes, duke perfshire ketu ruajtjen e cdo informacioni, qe mund te zbuloje identitetin e femijes apo e anetareve te tjere te familjes;	MPÇS, MRP, PP	ne vazhdimesi

- Te zhvilloje modele mbrojtjeje dhe riintegrimi per viktimat aktuale apo te ardhshme te trafikimit te femije qe jane jetime ose qe per arsye te tjera nuk mund te kthehen prane familjeve te tyre.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Te rishikohet rregullorja e institucioneve te perkujdesit per femijet jetime, ku te percaktohen detyrimet per zbatimin e procedurave te biresimit apo sherbimit te kujdestarise;	MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Sigurimi i masave te vecanta dhe procedurat per ri-integrimin e femijeve te trafikuar, apo femijeve jetime ne rrezik, ne perputhje me te drejtat dhe nevojat e tyre specifike;	MPÇS	deri ne Qershor 2005

- Organizimi i trainimeve me perfaqesuesit e strukturave shtetore, te pushtetit vendor dhe te institucioneve publike dhe jopublike, te angazhuar per mbrojtjen dhe riintegrimin e femijeve te trafikuar apo ne rrezik, per njohjen e legjislacionit shqiptar per femijet, te konventave te tjera te njohura nderkombetare dhe Udhezimeve te UNICEF-it; per menaxhimin e qendrave pritese dhe integruese; per standardet e trajtimit dhe kujdesit per femijet; per problemet e kujdestarise, biresimit dhe rehabilitimit.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Organizimi i kurseve te trainimit dhe formimit profesional, afatmesem dhe afatgjate me punonjesit sociale qe te realizojne funksione te specializuara te kujdesit per femijet, te parashikuara ne aktivitetet e permendura me siper; si dhe me punonjesit e strukturave shtetore qendrore dhe te pushtetit vendor qe ndjekin keto probleme;	MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	shtator 2005 e ne vazhdimesi

- Ofrimi i sherbimeve te reja per mbrojtjen dhe riintegrimin e viktmave aktuale apo te mundshme te trafikimit, nga institucionet e sherbimeve sociale publike e jopublike, te ndihmuara nga OJF-te, organizatat nderkombetare dhe donatoret.

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Krijimi i ekipeve te levizshme (Mobile) te ndihmes me perfaqesues nga strukturat e zbatimit te ligjit, te OJF-ve, te sherbimeve sociale dhe shendetesore per te ndihmuar ne referimin fillestar te te femijet dhe strehimin e tij;	MPÇS, MRP,MPV Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Krijimi i struktures se Mbrojtjes se Femijes prane njesive te pushtetit vendor, te perbere nga perfaqesues ne fushen e mjekesise, arsimit, sherbimit social, rendit, prokurorise, punonjesve lokale, si dhe nga perfaqesues te sektorit jo-qeveritar, pergjegjes per kordinimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimit te trafikut;	MPÇS, M.SH,MRP,MPV Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005
Te trajnohen strukturat e permendura me siper ne nivel qendror dhe prefektore;	MPCS, MRP, MPV Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Qershor 2006
Monitorimi dhe ndjekja e rasteve te biresimit, kujdestarise dhe ri-integrimit;	MPÇS, Komiteti i Biresimit	ne vazhdimesi dhe rast pas rasti
Sigurimi i ndihmes ekonomike apo i formave te tjera te ndihmes per familjet kujdestare apo familjet biologjike, veçanerisht per rastet kur keto te fundit nuk jane te implikuara ne trafikim dhe kur femijet e tyre kane denoncuar trafikantet;	MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	ne vazhdimesi dhe rast pas rasti

### 3. Hetimi dhe denimi i trafikanteve

- Te permiresohen procedurat per identifikimin dhe zbulimin e rasteve te trafikimit te femijeve, ndjekja penale dhe denimi i autoreve te veprave penale qe lidhen me te:

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Realizimi i bashkepunimit ne nivel kombetar dhe lokal, ndermjet strukturave te sherbimit social, mbrojtjes, rendit, ligjit dhe OJF e specializuara, per shkembimin e informacionit, kur dyshohet se femija eshte trafikuar dhe shfrytezuar ose eshte ne rrezik;	MPÇS, MRP,PP Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	ne vazhdimesi
Te perzgjidhen dhe te trajnohen oficeret policie, prokurorë dhe gjykatës, te caktuar per hetimin dhe ndjekjen e rasteve te trafikut te femijeve;	MRP, MD, PP	Shtator 2005 dhe ne vazhdimesi
Ngritja dhe funksionimi i seksioneve te te miturve prane Gjykatave te rretheve Gjyqesore te vendit si dhe funksionimi i sektoreve te vecante per hetimet ndaj te miturve, prane Drejtorive te Hetimit dhe te Kontrollit te Ndjekjes Penale ne Prokurori.	MD, PP, MRP	deri ne Shtator 2005
Zbatimi i nje qendrimi specifik ndaj mbrojtjes se deshmitarit ne rastet e femijeve viktime te trafikimit, nepermjet njohjes se te drejtave dhe vulnerabilitetit te deshmitareve femije gjate hetimeve dhe ne gjyq, si dhe krijimit te strukturave korresponduese per marrjen ne pyetje nga policia dhe prokuroria, dhe masat qe duhen marre per te shmangur ballafaqimin e femijes me trafikantin para dhe gjate procesit te gjyqit;	MD, MRP, PP Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	Dhjetor 2005 dhe ne vazhdimesi
Te sigurohet se organet e rendit dhe prokurorise te kene informacion te mjaftueshem per femijet, viktime te trafikut, duke marre parasysh moshen, te drejtat e tyre ne perputhje me legjislacionin vendas dhe instrumentat/nderkombetare, para se ata te vendosin nese do te deshmojne ose jo per trafikantin apo shfrytezuesin e tyre;	MRP, PP, MED	ne vazhdimesi dhe rast pas rasti
Sigurimi i asistences se nevojshme per femijet viktime edhe ne rastet kur ata vendosin te mos denoncojne personat qe i kane trafikuar apo shfrytezuar.	MD, MRP, PP,MPÇS	ne vazhdimesi dhe rast pas rasti
Marrja e masave per te garantuar te drejten e femijeve per t'u kthyer prane familjes, qendrave te pritjes apo atyre te kujdestarise, pas intervistimit te tyre nga ana policise gjyqesore;	MRP, PP, MPÇS	ne vazhdimesi
Ruajtja e fshehtesise se informacionit mbi femijet viktime, i cili mund te sjelle femijet ose ndonje anetar te familjes se tyre ne rrezik.	MRP, PP	ne vazhdimesi
Te ngrihet nje Regjister Kombetar per Krimet e kryera kunder femijeve, ku te regjistrohen te gjithë ata autore qe jane denuar per krime kunder femijeve, duke perfshire trafikimin, ne menyre qe te shmangët punesimi i tyre ne sektorin publik dhe privat, si dhe ne institucionet e perkujdesit te femijes;	MD,MPÇS,PP	deri me Dhjetor 2005

## 4. Kthimi vullnetar i asistuar i te miturve viktima

- Te rregullohen dhe financohen procedurat e Kthimit Vullnetar te Asistuar te Femijeve, Viktima te Trafikut:

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Negocimi i marreveshjeve te reja apo te permiresuara bilaterale me vendet fqinje apo vendet e tjera te destinacionit dhe tranzitimit, vecanerisht me Greqine dhe Italine, per njoftimin reciprok, akomodimin e sigurte dhe kthimin e rregullt dhe te koordinuar te femijeve viktima te trafikimit, nepermjet proceseve dhe procedurave qe respektojne te drejtat dhe interesat e femijeve dhe perspektivat e tyre per riintegrim social;	MPJ, MRP, MPCS	Shtator 2005 dhe ne vazhdimesi
Hartimi i standarteve per riatdhesimin e femijeve, viktima te trafikut, nepermjet kthimit vullnetar te asistuar te tyre, ne perputhje me interesin me te larte te femijeve, te drejtes se femijes per te vendosur te kthehet ose jo ne familjen, vendin e tij te origjines, ne perputhje me standartet nderkombetare per riatdhesimin (Konventa per Te Drejtat e Femijeve e Kombeve te Bashkuara);	MPCS, MRP Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Krijimi i nje strukture ne nivel qendror qe do te trajtoje problemet e mbrojtjes dhe kthimit vullnetar te asistuar te femijeve (Autoriteti Pergjegjes), viktima te trafikut apo ne rrezik trafikimi dhe kordinimit te procedurave te partnereve vendas me strukturat perkatese qeveritare, OJF, Organizatat Nderkombetare ne vendet kryesore te destinacionit, dhe vecanerisht me Greqine dhe Italine;	MPCS, Komiteti per Mundesi te Barabarta Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Qershor 2005
Zbatimi i projekteve per identifikimin dhe kthimin vullnetar te asistuar te femijeve shqiptare qe gjenden te pashoqeruar ne Itali dhe Greqi, duke u mbeshtetur ne eksperiencen e fituar;	MPCS,MRP Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	ne vazhdimesi
Te pergatiten me asistencen e OJF dhe Organizatave Nderkombetare flete-palosje apo buletine dhe t'u shperndahen femijeve viktimave brenda dhe jashte vendit, me informacion mbi statusin, situaten, te drejtat e tyre dhe sherbimet qe u ofrohen per ribashkimin me familjen si dhe procesin e riatdhesimit;	MPÇS,MPJ, MSH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005
Instruktimi i perfaqesuesve te sherbimit konsullor shqiptar mbi verifikimin e te dhenave, menyren e leshimit te dokumentave te udhetimit ne kohe per femijet qe mund te riatdhesohen;	MPJ Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Shtator 2005
Instruktimi dhe trainimi i personelit konsullor shqiptar per te aplikuar procedurat e njohura nderkombetare per mbrojtjen dhe njoftimin ne organet kompetente per femijet shqiptare te trafikuar apo ne rrezik shfrytezimi ne vendet pritese;	MPJ Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Shtator 2005
Informimi dhe trainimi i personelit te zyrave te Gjendjes Civile per leshimin e te dhenave te kerkuara per nje femije (kur, si dhe kujt duhet t'i jepet informacioni);	MPV. Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005

## 5. Koordinimi i partnereve antitrafik

Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse	Afati kohor
Krijimi ne nivel qendror dhe lokal i nje strukture per mbrojtjen e femijeve qe do te kordinoje dhe mbikqyre aktivitetet lokale dhe kombetare per arsimin, shendetin dhe sherbimet sociale, rendin, ndjekjen penale, strukturat e pushtetit vendor, dhe te bashkepunojte me Organizatat dhe OJF perkatese per zbatimin e detyrave qe rrjedhin nga Plani i Punes;	MPCS, MPV, MASH, MRP, DPPSH, PP, MSH Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri me Shtator 2005
Krijimi i nje rrjeti partneriteti per luften kunder trafikut te femijeve ne nivel rajonal dhe vendor (qarqesh e bashkish), me pjesemarres nga OJF-te dhe perfaqesues te sherbimeve sociale, mjekesore, arsimore, policore dhe te prokurorise ne nivel lokal, me qellim asistimin dhe keshillimin e viktimave dhe familjeve dhe koordinimin e sherbimeve shteterore ne nivel kombetar me sherbimet e OJF-ve, te organizatat nderkombetare, strehezat dhe institucionet e tjera mbrojtese;	MPCS, MPV,MRP,Prokuroria Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Dhjetor 2005
Negocimi i Memorandumeve te Mirekuptimit ndermjet ministrive dhe institucioneve te angazhuara ne luften kunder trafikimit te femijeve, parandalimin dhe mbrojtjen e tyre dhe OJF vendase dhe Organizatave Nderkombetare, per te rregulluar dhe percaktuar te drejtat dhe pergjegjesite e paleve, ne interes te transparences dhe te mbrojtjes ligjore reciproke te perfituesve dhe atyre qe i asistojne keta te fundit;	MSH, MPÇS Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Qershor 2005
Nxitja e koordinimit nderkufitar dhe nderkombetar ndermjet OJF-ve qe merren me trafikimin e femije, qendrave pritese, "hotline" dhe institucioneve te tjera respektive ne Shqiperi me homologet e tyre ne vendet fqinje dhe ato te destinacionit, me qellim zbatimin e politikave dhe masave te pershkruara me siper, vecanerisht te atyre qe lidhen me riatdhesimin vullnetar te asistuar;	MPJ, MRP, MPÇS,MSH Ne bashkepunim me Organizatat Nderkombetare dhe OJF	deri ne Dhjetor 2005
Krijimi i nje sistemi komprensiv dhe te koordinuar per mbledhjen, analizimin dhe shperndarjen e informacionit (te dhenat) per trafikimin e femijeve, bazuar ne nje metodologji te aprovuar nga te gjithte partneret shteterore, OJF-ve dhe organizatave nderkombetare;	MPÇS, MSH Ne bashkepunim me OJF dhe Organizata Nderkombetare	deri ne Shtator 2005



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I MINISTRAVE  
ZYRA E MINISTRIT TE SHTETIT PER KOORDINIM**

**Adresa: Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Tel: +355 4 256 844 Fax +355 4 230 846**

**MARREVESHJE BASHKEPUNIMI PER KRIJIMIN E NJE  
MEKANIZMI KOMBETAR REFERUES PER IDENTIFIKIM DHE  
ASISTENCE TE PERMIRESUAR PER VIKTIMAT E TRAFIKUT  
TE QENIEVE NJEREZORE**

**NDERMJET**

**MINISTRIA E PUNES DHE CESHTJEVE SOCIALE/DREJTORIA E  
PERGJITHSHME E SHERBIMIT SOCIAL SHTETEROR**

**QENDRA KOMBETARE PRITese PER VIKTIMAT E TRAFIKUT**

**MINISTRIA E RENDIT PUBLIK/DREJTORIA E PERGJITHSHME E  
POLICISE SE SHTETIT**

**MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME/DREJTORIA E SHERBIMEVE  
KONSULLORE**

**ORGANIZATA JO-FITIMPRURESE “VATRA”, VLORE**

**ORGANIZATA JO-FITIMPRURESE “TJETER VIZION”, ELBASAN**

**Dhe**

**ORGANIZATA NDERKOMBETARE PER MIGRIM - TIRANE**

## **NENI 1. PALET NE MARREVESHJE**

**Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale/Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve Sociale Shteterore, e perfaqesuar nga Drejtoresha e Pergjithshme e Sherbimit Social Shteteror, Znj. Natasha Hodaj;**

**Qendra Kombetare Pritese per Viktimat e Trafikut te Qenieve Njerezore, e perfaqesuar nga Znj. Natasha Hodaj, Drejtoresha;**

**Ministria e Rendit Publik/Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit, e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem, Drejtues Bajram Ibraj;**

**Ministria e Puneve te Jashtme/Drejtoria e Sherbimeve Konsullore, e perfaqesuar nga Sekretari i Pergjithshem, z. Roland Bimo;**

**Organizata jo-fitimpruese, “Vatra”, Vlore, e perfaqesuar nga Drejtoresha Ekzekutive, Znj. Vera Leskaj;**

**Organizata jo-fitimpruese “Tjeter Vizion”, Elbasan, e perfaqesuar nga Drejtori, Z. Arian Cala;  
dhe**

**Organizata Nderkombetare per Migrim (IOM), e perfaqesuar nga Drejtuesi i Misionit IOM-Tirana, z. Mauricio Busati,**

**Bien dakort per sa me poshte:**

## **Neni 2. PERKUFIZIME**

**Per qellime te kesaj Marreveshjeje, do te perdoren perkufizimet e meposhtme:**

- a) “Trafikimi i qenieve njerezore” do te thote rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave nepermjet kercenimit, perdorimit te forces ose formave te tjera te detyrimit, rrembimit, mashtrimit, shperdorimit te detyres ose nje gjendjeje dobesie, ose dhenia apo marrja e pagesave ose perfitimeve te llojeve te tjera per te arritur miratimin e nje personi i cili ka kontroll mbi nje tjeter, per qellim shfrytezimi. Shfrytezimi perfshin te pakten shfrytezimin e prostituimit te te tjereve ose forma te tjera te shfrytezimit seksual, punes se detyruar ose sherbimeve te tjera te detyruara, skllaverise ose praktikave te ngjashme me skllaverine dhe roberine, ose marrjes se organeve;
- b) Miratimi i nje viktime te trafikimit te qenieve njerezore per shfrytezimin e parashtruar ne nen-piken (a) te ketij neni, nuk do te merret ne konsiderate nese eshte perdorur ndonje nga menytrat e permendura ne nen-piken (a);
- c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i femijes per qellime shfrytezimi do te konsiderohet “trafik i qenieve njerezore” edhe nese kjo nuk perfshin ndonje nga menytrat e parashtruara ne nenparagrafin (a) te ketij neni;
- d) “Femije” do te quhet cdo person nen moshen 18 vjec;
- e) “Viktme e trafikimit” do te jete cdo individ i cili ka perjetuar disa ose te gjitha rastet e lartpermendura;
- f) “Qendra” quhen ato organizata ne Shqiperi te regjistruara nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale apo institucione te tjera shteterore si psh Ministria e Shendetesise per te dhene sherbime perkujdesjeje rezidenciale per viktimat e trafikut te qenieve njerezore.
- g) “Organizata” jane ato organizata te shoqerise civile te regjistruara ne Shqiperi, perfshire Qendrat e regjistruara per dhenie te sherbimeve rezidenciale, te cilat veprojne ne perputhje me legjislacionin shqiptar per tu dhene sherbime sociale viktimave te trafikut, dhe te cilat permbushin kushtet e paracaktuara nga Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale apo institucione te tjera shteterore si psh Ministria e Shendetesise, qe u lejojne atyre te behen pale ne kete Marreveshje.



## **NENI 3. QELLIMI I MARREVESHJES:**

Qellimi i kesaj Marreveshjeje eshte te permiresoje bashkerendimin nder-institucional per pritjen fillestare, mbrojtjen dhe ndihmen mjekesore dhe sociale per viktimat aktuale, te supozuara apo te mundshme te trafikut njerezor brenda dhe jashte Shqiperise nepermjet krijimit te nje Mekanizmi Kombetar Referues, qe do te rregulloje detyrimet dhe bashkepunimin mes te gjitha paleve te perfshira ne identifikimin dhe referimin, akomodimin dhe ndihmen, bashkimin me familjen, kthimin vullnetar dhe riintegrimin afatgjate te viktimave te trafikuar.

Te gjitha Palet ne kete Marreveshje pranojne nevojën per te dhene nje larmi me te gjere sherbimesh per viktimat, ne perputhje me nevojat dhe interesat e tyre. Keto sherbime gjithepershiresë mund te sigurohen me mire duke ngritur nje sistem efikas per kontaktimin, referimin dhe bashkepunimin ndermjet Paleve.

Per shkak te shkalles se larte te prekshmerise se femijeve, qe i ben ata shenjstra te lehta per shfrytezim, Palet vecanerisht pranojne nevojën per te permiresuar mbrojtjen dhe ndihmen e dhene per femijet viktimat te identifikuar, te supozuara apo te mundshme, dhe per te vene ne zbatim masa specifike per ndihmen dhe mbrojtjen e tyre brenda kuadrit te kesaj Marreveshjeje.

Te gjitha palet e perfshira ne kete Marreveshje pranojne duke firmosur, nevojën per te rritur bashkepunimin mes tyre per te siguruar sherbimet e poshtepemendura per te gjitha viktimat e trafikut njerezor, si pjese e nje qellimi te perbashket kombetar te intensifikimit te luftes kunder trafikimit te qenieve njerezore, rritjes se ndergjegjesimit te publikut per fenomenin e trafikimit, si dhe permbushjes se detyres shoqerore dhe morale te mbeshtetjes se ri-integrimit te viktimave te trafikut.

Krijimi i nje Mekanizmi Kombetar Referues per viktimat femije dhe te rritur eshte nje objektiv prioritar i Planit Kombetar te Veprimit kunder Trafikut te Qenieve Njerezore 2005-2007 si dhe i Strategjise Kombetare dhe Planit te Veprimit per Luftën kunder Trafikut te Femijeve 2005-2007. Firmosja dhe zbatimi i kesaj Marreveshjeje shenon nje hap te rendesishem drejt arritjes se synimeve te ketyre dy dokumenteve.

## **NENI 4. PARIMET BAZE**

E gjithë mbeshtetja dhe ndihma per viktimat apo viktimat e mundshme e te dyshuara te trafikut, si te rritur ashtu dhe femije, ne kete Marreveshje do te bazohet tek respektimi i parimeve baze te meposhtme:

- Trajtim i bazuar tek te drejtat e njeriut, i orientuar drejt viktimes, dhe jo-kriminalizues i te gjitha viktimave te trafikut te qenieve njerezore;
- Te ruhet siguria dhe anonimiteti i viktimave duke mos u treguar asnjehere personave te paautorizuar emrat apo vendndodhjet e viktimave, apo te qendrave per viktimat;
- Sigurimi i sherbimeve dhe akomodimit per viktimat duhet te behet ne baze vullnetare, me miratimin dhe informimin e plote te te gjitha viktimave; duke u siguruar qe viktimat e rritura te jene gjithmonte te lira te refuzojne sherbimet e ofruara apo te largohen nga nje qender nese duan, dhe qe viktimave-femije tu jepet mundesia te marrin pjese ne vendimmarrje ne lidhje me ceshtjet e tyre;
- Perparesi do tu jepet gjithmone interesave te viktimave te trafikut, sidomos atyre femije;
- Mbrojtja e te drejtave te viktimave dhe e drejta e tyre per tu informuar per te drejtat e tyre ligjore, etj, dhe asistencen, qe mund tu vihen ne dispozicion, do te sigurohen gjate gjithë procesit te identifikimit, referimit dhe asistences, si dhe gjate zbatimit dhe monitorimit te kesaj marreveshjeje.
- Mbrojtja dhe mbeshtetja nuk do te kushtezohen me pranimin per te deshmuar;
- Dhenia e ndihmes se duhur viktimave me nevoja te vecanta, sidomos ne rastet me aftesi te kufizuara, crregullime psiko-sociale, semundje apo shtatzani;
- Per viktimat-femije do te kujdesen profesioniste te trainuar posacerisht per keto raste, te cilet jane te ndergjegjshem mbi te drejtat dhe nevojat e vecanta te viktimave-femije si dhe mbi ceshtjet gjinore.

## **NENI 5. ANGAZHIMET E PALEVE.**

*Ne perputhje me Nenet 2, 3 dhe 4 te kesaj Marreveshjeje, Palet do te veprojne si me poshte:*

### **A. Ministria e Rendit Publik/Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit:**

- 1) Do te raportoje tek “Autoriteti Pergjegjes” kombetar i krijuar brenda MPCPS per te bashkerenduar dhe perpunuar te gjitha referimet per viktimat e trafikut (shih Nenin C.1.) te gjitha ceshtjet e referuar tek ta nga homologet e huaj ne lidhje me kthimin, deportimin, etj te viktimave apo viktimave te mundshme te trafikimit, dhe do te ndihmoje ne gjetjen e familjes, sipas kerkeses se Autoritetit te siperpermendur.
- 2) Duke perdorur strukturat e policive kufitare, kriminale dhe anti-trafik ne Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) dhe Drejtorite e Qarqeve, do te kryeje identifikimin, pritjen dhe intervistimin paraprak te viktimave apo viktimave te dyshuara a te mundshme te trafikut, dhe do te bashkepusoje me “Autoritetin Pergjegjes” kombetar ne referimin e ketyre viktimave per gjetjen e familjeve dhe ri-bashkimin me to, per akomodimin dhe ri-atdhesimin e ndihmuar, apo per ndihme ri-integrimi, ose tek Qendra Kombetare Pritese per Viktimat e Trafikut te Qenieve Njerezore (tani e tutje te permendur si QKPVT), ose Qendrat e “Vatra”, “Tjeter Vizion”, IOM (tani e tutje te permendura si “Qendrat”), apo nepermjet Organizatave te tjera te regjistruara per te siguruar sherbime per viktimat e trafikut te qenieve njerezore (tani e tutje te permendura si “Organizatat”).
- 3) Nese strukturat policore nuk kane mundesi te kontaktojne Autoritetin Pergjegjes, ato duhet tia referojne ceshtjet qe kane nevojte per akomodim dhe asistancete menjehershme institucionit me te afert qe ofron sherbime te tilla, i cili mund te gjendet ne listen me keto institucione qe ka shperndare MPCPS. (shih dhe Nenin 5.C.2.).
- 4) Do te sigurohet qe te gjitha personat e kthyer, apo te papranuar shqiptare apo persona te tjere te identifikuar si viktimat, apo viktimat te supozuara a te mundshme te trafikut, te intervistohen sa me shpejt dhe ne perputhje me nevojat e tyre si viktimat, nga strukturat policore te siperpermendura, ne pranine e punonjesve sociale shtetore apo nga OJF-te, te cilet te jene te trainuar ne menyre specifike per te punuar me viktimat e trafikut. Ne rastet kur e kerkon viktimat, intervista do te behet ne vend te vecante, me pranine e punonjesit social.
- 5) Do te lejoje qe punonjes sociale nga MPCPS apo Organizata pale te kesaj Marreveshjeje, te jene te pranishem ne te gjitha PKK te Shqiperise per te marre pjese ne intervista apo per te dhene mbeshtetje per viktimat e mundshme apo te dyshuara te trafikut – shih 5.A.4.
- 6) Ne bashkerendim me “Autoritetin Pergjegjes”, Qendrat dhe Organizatat, do te siguroje qe, ne rastet me femije te kthyer, femije “inad” apo femije te identifikuar brenda vendit si viktimat, apo viktimat te supozuara/mundshme, intervistimi i femijes te jete prioritar dhe te behet ne nje vend te vecante, duke perdorur menyra te posacme per femijet. Intervistimi do te behet nga nje punonjes policie dhe nje psikolog/punonjes social, te dy keta te trainuar posacerisht per te punuar me femije-viktimat te trafikut te qenieve njerezore, dhe per te respektuar gjate gjitha kohes mireqenien dhe interesin e femijes.
- 7) Do te siguroje qe strukturat policore te siperpermendura, dhe punonjesit sociale te autorizuar, te perdorin kriteret standarte te miratuara per percaktimin e viktimave te mundshme (Shtojca 1 e kesaj Marreveshjeje) gjate perpunimit dhe intervistimit te te kthyerve, personave “inad” dhe viktimave te mundshme te trafikut.
- 8) Do te perdore si duhet bazen e te dhenave prane Drejtorise se Menaxhimit te Informacionit dhe Teknologjise te Policise se Shtetit per te hapur, mirembajtur dhe perditesuar dosjet elektronike te ceshtjeve per te gjitha te kthyerit viktimat apo te dyshuar si viktimat, etj, si dhe do te mbledhe dhe perpusoje te gjitha te dhenat mbi te kthyerit, sipas procedurave standarte te punes te Sistemit te Menaxhimit Total te Informacionit (TIMS) te Policise se Shtetit.
- 9) Do tu jape Dokumenta Kombetare Identiteti, sipas nevojave, viktimave shqiptare te trafikut, dhe Leje te Perkohshme Qendrimi te gjitha viktimave te huaja te cilat deshirojne te qendrojne ne Shqiperi per qellime reflektimi dhe rehabilitimi, riatdhesimi te ndihmuar, apo per te bashkepunuar me organet e drejtesise shqiptare.

- 10) Do të raportojë dhe referojë të "Autoriteti Pergjegjës" kombëtar, dhe, kur është e nevojshme, tek Qendrat apo Organizatat, të gjitha viktimat e huaja të trafikut të identifikuar në Shqipëri. Këto viktimat apo viktimat të dyshuara nuk do të detyrohen të kthehen në vendet e tyre të origjinës derisa të jenë intervistuar nga policia dhe/ose prokuroria, të jenë ekzaminuar nga një grup ekzaminues, të kenë patur mundësi për përfitim të shërbimeve sociale, tu jete dhënë mundësia për të aplikuar për leje qëndrimi të perkohshme për periudhë reflektimi, dhe (në varesë të dëshirave të tyre) të kenë filluar procedurë denoncimi apo ndjekjeje penale, dhe derisa të jenë perfunduar procedurat e duhura për riatdhësim, në bashkëpunim me strukturat homologe të vendit të tyre të origjinës. Të gjitha veprimet në lidhje me pritjen, akomodimin dhe mbrojtjen fillestare të viktimave të tilla do të jenë përgjegjësi e "Autoritetit Pergjegjës" kombëtar, në bashkëpunim me shërbimet e caktuara dhe të specializuara të policisë, prokurorisë dhe institucioneve të tjera shtetërore. (Kjo Marrëveshje përfshin, aty ku është e nevojshme, udhëzimet mbi procedurat ekzaminuese për viktimat e huaja të trafikimit dhe emigrantet e paligjshëm, të nxjerra me datë 12 tetor 2004 nga Ministri i Rendit Publik; referimet e viktimave të huaja apo emigranteve të paligjshëm duhet të ndjekin udhëzimet e dhëna në procedurat e sipërpervendura).
- 11) Do të ruajë ndertësat e QKPVT dhe të Qendrave apo Organizatave të tjera sipas nevojave, dhe do të sigurojë mbrojtje për përfituesit, punonjësit sociale dhe personelin e QKPVT dhe Qendrave e Organizatave të tjera, nëse kjo shihet e nevojshme.
- 12) Në bashkëpunim me Autoritetin Pergjegjës kombëtar, do të garantojë siguri gjatë transportimit të viktimave prej drejtorive policore të qarqeve apo PKK tek familjet e tyre apo QKPVT, etj. Sipas nevojave, dhe duke marrë parasysh interesin e viktimes, transportimi mund të kryhet me automjetet civile të Qendres ndihmëse, Organizates apo familjes.
- 13) Të mundësojë transportim të sigurtë dhe masë të tjera sigurie sipas nevojave për viktimat që bashkëpunojnë me policinë/prokurorinë, dhe/ose kanë bërë kalëzime penale kundër trafikuesve të tyre, duke i mbrojtur ato deri në përfundim të këtyre çështjeve penale, apo dhe me pas, në përputhje me Ligjin mbi Mbrojtjen e Dëshmitarëve, Ligjin mbi Gjykatat e Krimeve të Rënda, dhe vendimet e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunetoreve të Drejtësisë.
